

BIBLIOTEKA

BHH-1
B 56



JORGO BLLACI

Zërat e Natës

poezi



BH-1
B56

**JORGO
BLLACI**

Redaktor
AUREL PLASARI

Titullor
ALMA XHAFA

ZERAT E NATES

poezi

SHTËPIA BOTUESE
E LIDHJES SË SHKRIMTARËVE

* * *

Në një rreth miqsh më pyetën një ditë:
«Pse, kur në vjersha titulli mungon,
Shënohen shpesh tre yje? Kjo traditë
Ka mbetur kot, apo diçka tregon?»

«Ka yj të ndezur, ka dhe yj të shuar,
Që drita, — u thash, — vazhdon u vjen mbi

Po ka më larg dhe yj të pazbuluar,
Se rrezja s'u ka mbrritur gjer te ne.

Dhe poezia, porsì galaktikat,
Kështu tre llojesh yjtë e vet i ka;
Prandaj, kur s'vihen tituj mbi lirika,
Shënohen shpesh tre yje. . . dhe ndër ta,

dhé;
1/20/10

I pari shpreh të bukurën q'e shohim,
I dyti, atë që në kujtime rron,
Kurse i treti, atë që ne s'e njohim,
Po vete poezia e zbulon.»

1970

* * *

Shtegëtar, që kalon monopatin,
Mos e nëm kukuvajkën e shkretë!
Lere zogn' e përbuzur prej fatit
Të këndojë pas qejfit të vet!

Kushedi ç'i ka hipur në kokë,
Kushedi se ç'kujtim e gëzon
Këtë natë që era mbi tokë,
Porsi kujë violinash ushton.

1957

* * *

Kaq dëshira ne po mbajmë fshehur,
Sa dhe vetes trembemi t'ia themi.
Rrugëve të jetës, si të dehur
Endemi dhe s'dimë se ku vemi. . .

1957

BULKTHI

Gjeni i çuditshëm i natës dimërore!
Kur mjegull' e zyrtë djerrinat i mbulon,
Diku te një strehëz, nën shtresën e dëborës,
Me këngë të thjeshta, pareshtur ti gjëmon.

Në verën e ngrohtë, gjinkallat kur zhuzhonin
Në kore gazmore, ndër drurët plot blerim,
Ne këngët e tua përse nuk i dëgjonim?
Mos vallë ke heshtur me brëngë e përmallim?

Fo vera s'la gjurmë mbi degëzat e ngrira.
U zhdukën gjinkallat, gjithçka përreth u zhvesh.
Si miku që s'ikën në çastet e vështira,
O shpirt ligjëronjës, ti mbete midis nesh!

Dhe ndonse thëllimi i natës dimërore,
Atje ndënë strehëz, të rreh me ftohtësi,
Në gjoksin e vogël ti gjen zjarre madhështore
Për këngët e thjeshta plot ndjenjë e dliresi!

1957

* * *

+

Brengën e madhe mbyta në një gotë;
Si qenkam dehur sonte s'e kuptoj!
Për gjërat më të bukura në botë
Sa më pëlqen të rri e t'ëndërroj.

Sa më pëlqen gazmor t'i bie lirës,
Po ku të lë mendimi të dëfresh?
Demon, demon i madh i hapësirës,
Akoma ti kërkon të më gënjesh?

Ti po ma nxin me brenga djalërinë,
Ti po m'i shqyen brinjët, po më ç'mend, —
Ose më kthe sërishmi qetësinë,
Ose më sill këtu tërbimin tënd!

Se do t'i qepem qiellit kësaj nate,
Për flokësh ta kap hënën e me të
Të sillem hapësirës së pamatë
E të mos zbres mbi tokë kurrë më!

1957

BALADË

S'di nga më vjen kjo këngë e mbytur shpendi,
Që pa pushim në zemër më buçet:
«Në një kafaz të bukur prej argjendi
Dikur më mbylli mizorisht një mbret.

Me robërinë time zbukuroja
Stolitë e tij të ngurta në saraj;
Me këngën time brengës i tregoja
Sa ma zhuriste shpirtin zjarri i saj.

Po një mëngjes, deriçkën e kafazit
Sekush e hapi. . . Unë u bëra plumb!
Në xhamat e dritares u përplasa,
I theva e çava qiellit pa fund,

Dhe si pushtova duke fluturuar,
Me krahët gjak, të thellat kaltërsi,
E prita vdekjen pa u dëshpëruar,
Sepse e ngopa shpirtin me liri!»

1958

NETËS

Kushtuar P. J.

Kaq e shtrenjtë kurrë s'më je dukur,
Ti vërtet nuk paske shëmbëllim!
Ah, moj Neta, sytë e tu të bukur
Çmendurisht i deshte miku im!

Nëse këtë çast i ngrysur mbeta,
Duke të vështruar ty kështu,
Ti mos m'u çudit aspak, moj Neta,
Më kujtuan mikun sytë e tu.

Sa dëshirë do të kisha sonte
T'ju vështroja bashkë që të dy:
Vetëm ta dëgjoje të këndonte
Vargjet që me zjarr t'i thuri ty!

Ndoshta sot, që vite pas la jeta,
Miku prap në shpirt të mban diku. . .
Ish e bukur dhembja e tij, moj Neta,
Aq sa ç'janë edhe dy sytë e tu!

1958



Këngë, jetë, dritë, hapësirë,
Brohori jehonash plot kumbim!
Ëndërrat e shpitrave të dli­rë
Kaltërojnë qiellin pa mbarim!

Eja, mike, flakja zemrës velin
Që të ka mbuluar me mërzi:
Gonxhet po shpërthejnë, shih, po çelin
Mijra lule, mijra dashuri!

Mjaft me drojtjen tënde dhe ngurrimin!
Sot pranvera zgjon kudo gëzimin —
Jepju e tëra vrulleve të tua,

Eja të të puth, të të pushtoj!
Njerëz, që të gjithëve ju dua, —
Lermëni, si mik, t'ju përqafoj!

1958

HARABELAT

S'ka më freski dhe lule në lëndinë;
Nga diell' i gushtit, bari u tha, u dogj;
Veç harabelat zheg e vapë s'dinë, —
Sa të çuditshëm janë këta zogj!

Të gjithë tok, në tufën e gëzuar,
Përmbi lëndinë sillen papushim,
Pastaj më vijnë e duke cicëruar,
Më pëshpërisin fjalë pa kuptim.

E ç'po më thoni vallë, o çamarrokë,
Që nuk m'u ndatë gjithë rrugës sot?
Ju me të gjithë jeni miq e shokë, —
Ku dëni ju se ç'halle ka kjo botë!

Ndërrojnë stinët, shemben kohët, ligjet,
E ju s'e vrisni mendjen për asgjë;
Për ju të shtrenjta mbeten fushat, brigjet,
Ku të çkujdesur silleni gjithnjë.

Po ndonëse dini vetëm fluturime
Dhe ngado shkoni, s'thurni as fole,
Ju s'vajtët kurrë larg në shtegëtime,
Ju s'e braktisët kurrë këtë dhë,

Po varfërisht u rritët, tok me mua,
Në këtë vis, ku shkabë e rreptë rron;
Dhe unë ndoshta për këtë ju dua, —
Një mall foshnjor me ju më vllazëron. . .

1958

* * *

Pemët anës rrugës dridhen në vallzim.
Seç më paska shpirti sonte kaq gëzim!

Fryj, moj erë e vjeshtës, gazi si s'të çmend?
Gjallëroje vallen ti me vrullin tënd:

Dasmë kemi sonte, nuk e more vesh?
Niset mikja nuse! Gjithë bota qesh!

Dhëndër, mor vëllaçko, mbush e zbraz dolli:
Ngatërruam vendet sonte unë e ti.

Nuse, qesh, moj nuse! sonte pse të qash?
Rrofsh e qofsh i lumtur, mik o dollibash!

Mbushi mirë e bukur gotat, pa kursim:
Në mbaroftë vera, kemi gjakun tim!

Në s'të del rakia, merr lotët e mi:
Nuses jepi verë, dhëndërit — raki!

Se do pi dhe unë, sa të bëhem thumb:
Bregën apo mendjen, djalli di se ç'humb!

Vete vjen dollia, kënga nuk pushon.
Jashtë, nga gëzimi, rruga po gjëmon.

Tunden e kërcasin pemët me rrëmbim,
Duke hedhur valle tok me shpirtin tim.

Fishkëlli, moj erë, fort, se po më çmend!
Gjallëroje vallen me tërbimin tënd!

1958

* * *

Unë e di që ti tani për mua,
Pranë stufës rri edhe mendon:
«Jorgo, Jorgo! — ti me vete thua. —
Këtë natë ku po e kalon?

Vallë, mos ndonjë vejushë e mbetur
Të ka marrë sonte në shtëpi
Dhe të puth e të pushton e etur,
Gjithë epsh e gjithë egërsi? ...»

S'ke se ç'bën, e dashur, rrugë e shkretë
Në të huaj shtretër të përplas!
S'kanë faj vejushat mendjehleta
Që në brengën time gjejnë gaz!

Ti sërishmi mendjen vret për mua,
Pranë stufës, brengën duke fshehur:
«Jorgo, Jorgo! — prap me vete thua, —
Mos po endesh rrugëve i dehur?»

Jo, e dashur, sonte fli e qetë:
Në një park të heshtur, fill i vetëm
Po qëndroj, porsi një zog pa fletë;
Përmbi stol i krrusur, qaj e mekem
Dhe pse qaj nuk e kuptoj as vetë...

1959

MBRËMJE USHTARËSH

Ah, më kujtohet. . . muzgu sa kish rënë.
Në kaltërsinë e thellë, me nxitim,
Lundronin retë e vogla, porsi vela.
Ish natë e bukur, natë pa rrëfim!
Një dorë e ashpër dridhej nëpër tela, —
Kitarë e dhembshur qante pa pushim.
Vajtimn' e saj të ëmbël tek dëgjonim,
Të heshtur ne kujtonim, ëndërronim.

Mbështetur përmbi brryla, pranë meje,
Një shok vështronte larg me dhembshuri;
Çdo tingull, që këputej nga kitara
E shpinte pa kuptuar përsëri
Te vatra e bëlbëzimeve të para,
Te vatra, ku u rrit me dashuri;
Dhe malli kraharorin i pushtonte,
Kur mëmën edhe t'afërmit kujtonte.

Përbri atij, me sytë gjysmë mbyllur,
Një tjetër kishte rënë n'ëndërrim:
Me zjarrin përvëlues, dashuria
Në shpirt i sillte gaz edhe trishtim;
Në qiell, ylli i shpresave të tija
I ndrinte dhe i shuhej pa pushim...
Eh, dashuria, sa t'i deh mendimet!
T'i ëmbëlson dhe brengat, dhe mundimet!

Më tej, te zjarri, tjetri piqte misra,
Pa vrarë mendjen fare për asgjë;
Me bisht të syrit, heshtas na shikonte
Edhe çuditej pse s'i flisnim më.
Kurse kitara dhembshurisht vajtonte
Dhe sipër retë e vogla, një nga një,
Lundronin porsi vela argjendore
Drejt viseve të largëta qiellore...

1959

* * *

Dëgjo ç'thonë gjethet më të rënë,
Këtë natë vjeshte me stuhi:
«Lamtumirë, e shtrenjta dega mëmë!
Tokë e ftohtë po na merr në gji!

Ah, moj tokë, tokë! kur bleronim
E të bënim fllade plot hare,
Ti na deshe, se të hijeshonim.
Po tani? Medet, të ngratat he!

Na këput nga dega erë e fortë.
Ah, moj erë! Pse kështu po fryn?
Mirë toka, që na pret e ftohtë,
Po ti pse me kaq rrëmbim na shtyn?

Si të deshte qejfi ty, moj erë,
Ne dikur u drodhëm pa pushim...
Lamtumirë, o degë, o mëmë e mjerë!
Ti na ndje për këngën plot ankim!»

1959

* * *

S'e marr vesh, o Jorgo, punën tënde:
Gjithë natën endesh vetmitar.
Mblidhe more veten, se u çmende!
Mendje do na shesësh, apo çfarë?

Gjenden fshehtësitë e kësaj bote
Me një harpë krahut, siç bën ti?
E në fund të fundit, fjala jote
As që ngroh e as që ftoh njeri,

Se ti s'kuvendon me njerëzinë,
Po me zogj e me korije flet, —
Edhe kur këndon për dashurinë,
Qan me mall e përdëllime pret.

Pika që s'të bie, kur na thua
Se na qenke kaq melankolik!
Po ç'na duhen vuajtjet e tua,
Kur ne kemi halle plot, or mik!

Nuk të them: braktise poezinë! —
Është e rëndë kjo për shpirtin tënd.
Por, të paktën, rro me njerëzinë,
Në kërkon të shkruash gjë me mend!

Ja, kështu me veten kuvendova,
Zemërçelur edhe me guxim,
Kur një tog me vjersha përvëlova
Në një natë prilli plot shkëlqim. . .

1959

* * *

Ra nata mbi fushën pa anë,
Zefiri shelgjishtat përkund.
Po shkasih karrocat me sanë
Në pluhur të rrugës pa fund.

Kojrillat mërguan në jugë
Dhe pylli së thelli rrënkon.
Dikush, në të heshturën rrugë,
Një këngë të dhëmbshur këndon.

Dhe ikin karrocat me sanë,
E zëra nuk ndihen gjëkund.
Mendimet pas tyre ç'më vanë,
Në mjegull të fushës pa fund...

1960

FROSINA

Moj e bukura Janinë,
Qaj e qesh për bijën tënde!
Ç'vajte bëre, moj Frosinë,
Ali Pashën na e çmënde!

Mbyte veten, moj e varfër,
Që në dorë mos i bije!
Mbi një shkëmb te gjoli i kaltër,
Pasha fshan prej dhëmbshurie.

Krrusur krruspull përmbi shpatë,
Drithmërimën s'e mban dot;
Mjekrr' e thinjur, mjekrr' e gjatë,
Seç iu njom e gjithë me lot.

Gjoksin flakë duke shqyer,
Çohet e buçet me tmerr:
«Zbrazni shpejt në gjol t'urryer
Njëqind thasë me sheqer!

Që për jetë t'ëmbëlsohet
Ujët, ku po pi ajo!»
Muzgu bie, toka ftohet,
Terri i natës ra kudo.

Sonte gjumë s'ka Janina.
Valë e gjolit diç po thotë. . .
Ujë t'ëmbël pi Frosina,
Ali Pasha, helm e lot!

1960

* * *

Kur padashur humbas ndër kujtime,
Mos më shih me trishtim e mërzi;
Mos m'u ngrys, moj e bukura ime, —
Koha shkon e më s'kthen përsëri.

Por nga mjegull' e kohës së ikur,
Ndodh që shpesh ndonjë zë na jehon
Mallëngjenjës, i largët, i mbytur, —
Dhe padashur në shpirt na trishton...

1960

* * *

Kojrillë, kojrillë,
Në gji të korijes së heshtur,
Pse qan ti me kaq dhembshuri?
Shelgjishtet u zhveshën dhe qielli me re
është veshur,
Pse s'ikën me shoqet dhe ti?

Po vijnë thëllimet, moj motër,
Po vijnë murrllanet, —
Ti strehë në ç'kënd do kërkosh?
Të nisesh e vetme në jug, nuk të lënë
tufanet,
Dhe rrugët s'i di nga të shkosh.

Ç'të fshehtë të dhembshur
Në gji po të mban ty korija,

Që sonte me shoqet s'po shkon?
Mos vallë të mbeti në hijet e saj dashuria
Dhe ti, duke qarë, e kërkon?

Prej dhembjeve ndoshta
Të humbësh aty ti je gati,
Pa lënë një gjurmë gjëkund, —
Po pse, moj kojrrillë, t'i jepesh symbyllazi
fatit,
Kur jeta ka fund edhe fund?

Po humbe një herë
Një çast lumturie, hareje,
Me vaje më s'mundesh ta kthesh, —
Ti je fluturake, moj motër, rrih flatrat
në qieje,
Dhe prap lumturi do të gjesh!

1960

* * *

Sy fëminorë dhe plot me shkëlqim nga
mendimi,
T'ëmbël, të thellë e të çiltër, si qiell pranveror,
Gurra ku nis e në heshtje buron frymëzimi,
Porta ku mbyllet pas tyre një kopësht prrallor!

Sy të çuditshëm, yje të kaltër, të dliirë, —
Thellë në zemër të shohin me gaz e dëshirë,
Thellë në zemër të djegin me zjarr dashuror!

1960

* * *

✓

Më vjen turp të qaj i heshtur,

Si një shelg përbri moçalit!

Dua të gjëmoj pareshtur,

Porsi lisi majë malit.

Rreth kurorës, shpesëria

Le të mos më cicërojnë;

Që prej zgavrave të mia,

Shkabat le të vigjëlojnë.

Degët e fuqishme dua

Të më tunden nëpër erë;

Papushuar përmbi mua

Borë e virgjër le të bjerë.

Sipër akujve të ftohtë,
Do të ngjitem gjer te retë,
S'do më vijë keq, në ndodhtë
Të zhuritem nga rrufetë!

Se n'u dashtë të zhuritem,
Do zhuritem majë malit,
Po s'do qaj e s'do nemitem
I përrulur, bri moçalit!

1960

TUFANI

Nëntogeri gjithnjë më pat thënë:
«Shok ushtar, duhet bindje n'ushtri!»
Porse unë atëherë kam qenë
Kokëkrisur, siç jam dhe tani.

.

Çmendurisht unë e dua tufanin, —
Sidomos atëherë n'ushtri,
Ku kish dreqër në vend të më mbanin,
Kur dëgjoja gjëmimet e tij!

Një të diel pushimi dhjetori,
Tek shëtisja me shokët plot shend,
Përmbi krahë tufani më mori
Dhe më bëri të bridhja pa mend.

Më përplasej në gjoks erë e fortë
Dhe më mbushte me gaz e më dehte. . .
Po më zuri një shi, more shokë,
Një rrebesh, që më solli në vete!

Erdha mardha e ngriva aq shumë,
Sa u bëra si dreqi pishman.
I thash vetes: përse bre, pa punë,
Të baresësh kështu në tufan?

Po rrebeshi gjithë fushën e nxiu.
Ku të gjeja një strehë? Për fat,
Pash diku një kasolle bariu,
Që m'u duk n'atë çast si pallat!

Nëpër shqotën e rreptë e rrebele,
Nisa vrapin drejt saj menjëherë.
Do më bënte baloshi fërtele,
Po mos dilte një vashëz në derë.

«Ç'lumtëri!» — pëshpëris i çuditur
Edhe shtangem prej gazit në vend!
Kjo kasolle, kjo vajzë, papritur
Robert Bërnsin më sollën ndërmend.

Në një vjershëz ai kishte shkruar,
Se një vajzë e shpëtoi në tufan.
«Diç do jem, — thash dhe unë i gëzuar, —
Që papritur kështu po më ngjan!»

Vetëtimthi leshverdha fshatare,
Si sorkadhez e trembur më pa.
Dhe pastaj, me një ndrojtje mitare,
«Urdhëro në kasolle...» — më tha.

Ula kryet e pragun kalova,
Me një drithmë të thellë në gjí.
Por m'u shemb gjithëcka që mendova,
Se te zjarri qe plaku bari!

Kur ai, me vështrimin drejt meje,
Mërmëriti: «Ku shkon nëpër shqotë?»,
Unë ndjeva papritur ndër deje
Një rrëqethje të ftoht' e të fortë.

Mblodha veten e vajta te zjarri,
Zura vend dhe i thash menjëherë:
«Epo, xhaxho, detyr' e ushtarit
As që pyet për shqotë e për erë...»

.....

Në kujtesë dhe sot më ka mbetur
Çdo vështrim i leshverdhës, çdo gjest.
Atë natë, kur rash për të fjetur
(Vetkuptohet se ku: në arrest!),

Papushuar në shpirt më kumbonte
Ëmbëlsisht zëri i saj vashëror.
Gjithë ankth, prisja ditën t'agonte
Dhe takimin gazmor dashuror.

Por agoi, u ngrys, prap agoi. . .
Unë s'pashë as fushë, as rrugë.
Komandanti pastaj më dërgoi
Me shërbim, diku tutje në Jug.

Kur u ktheva, kish ardhur pranvera,
Kishte nisur të zgjohej prap jeta,
Po në fushë, mes lulësh të tjera,
Më të bukurën lulc s'e gjeta.

Në repart, disa shokë më thanë,
Se një vajzë më kishte kërkuar,
Po pastaj, s'di në ç'mal, me babanë,
Tok me grigjën ajo kishte shkuar. . .

Ato vite, s'di ç'shpresa më mbanin,
Që ta shihja ndokur. . .
Dhe prandaj
Çmendurisht unë e dua tufanin,
Se më shfaqet fytyrëz e saj. . .

1963

* * *

Gjithë fusha humbi nëpër mjegull.

E brengosur hëna e plotë ndrin.

Ç'po më thua, moj fatlumja pjergull,
Që mbi gjoks të plepit shushurin?

Ti, përbri çdo druri të të mbillnin,
Do ta dridhje shtatin plot harbim,
S'do të ndieje brenga të të ndrydhnin,
Se ti s'njeh as mall, as pikëllim.

Por, e shtrenjta ime larg, moj pjergull,
Bri një tjetri, brengën s'përmban dot,
Tret vështrimn' e dhembshur nëpër

mjegull

Edhe, mbase, fshehtas qan me lot.

1960

* * *

Ti këdo mbi dhë do ta çuditje,
Mike moj, që s'vure mend një herë;
Kur më sheh me vajza në shëtitje,
Pse sërishmi bëhesh pikë e vrer?

Foshnje ishe, foshnje, mike, mbete,
Ndonëse për dikë tani je grua;
Ç'dreqin ke, ç't'u shkrep pas kaqe vjetesh,
Që xheloze bëhesh prap për mua?

Unë kurrë ty s'ta kam rrëfyer
Brengën, që në shpirt mezi përmbaj;
Dashuria, dashuri' e fyer.
Gur më bën e nuk më lë të qaj.

Ja kështu, moj mike, qenka jeta:
Ndodh që nga një herë, për çudi,
Lodhet prej mësimeve të veta
Edhe bëhet foshnje, porsì ti.

Ne s'ë qeshim tekanjozen jetë,
Po kur ne gabojmë, ajo harron:
Ndonëse marrëzira bën dhe vetë,
Rëndë ne na tall e na ndëshkon.

Mike, që më bëre të trishtuar,
Të të qesh, as që më shkon ndërmend, —
Është i gjerë shpirt' i përvëluar,
Ka një vend dhe për gabimin tënd!

1961

* * *

Kur buzëqesh plot gaz e shënd,
Ti ndrin gjithë ëndërrat e mia;
Nga thellësirë e syrit tënd
Vështron e çiltër dashuria.

Hutohem, mendjen krejt humbas,
Magjepsem pas atij vështrimi;
Më grish padashur n'atë çast
Një vis i largët ëndërrimi,

Ku vetëtin në qiellin blu
Gëzimi, jeta, lumtëria,
Ashtu siç ndrin në sytë e tu,
Në sytë e qeshur, dashuria!

1961



* * *

Ne fshehtazi shkëmbejmë shpesh vështrime,
Po sot një hon i thellë po na ndan;
Në fund të tij, si foshnjëzë jetime,
Me dhembje dashuria jonë qan.

Pa ditur se përse, pa lot, pa fjalë,
Pa puthje, ne u ndamë nëpër terr.
Pasionet u rronitën mengadalë
Dhe humbën në një mjegull plot mister.

Dhe sot, që me pendim, me mall a vajtje,
Të shkuarën sikush në shpirt përmban,
Ne heshtim kryeulur e me drojtje,
Si vjollca, anës honit që na ndan.

1961

SONET I PËRMBYSUR

S. Pantazit

Dorë e brishtë ngriu përmbi lirë, —
Shterri gurrë e lotit dashuror!
Shpirti i bardhë, si një re e lirë,

Fluturoi me flladin pranveror,
Për të nisur lart në kaltërsirë
Të pafundmin shtegëtim qiellor!

Fluturim të mbarë, o shpirt fëmije! —
Zemr' e trishtë e mikut të uron. —
Qoftë i ëmbël flladi, që të shpie
N'ato vise, ku veç malli shkon!

Unë e di, përjetë andej s'do mbesësh,
Miqtë e dashur nuk do t'i harrosh:
Yll ti do të bëhesh e, mes rrezesh,
Rishmëz do të zbresësh t'i takosh!...

1962

* * *

Natyrë e përtëritur në pranverë,
Një vashe të llastuar i përngjan:
Prej dufesh kalimtare, herë a herë
Rrëmbehet edhe vrullet s'i përmban.

Në kulm të lumtërisë e të gëzimit,
Papritur diç kujton me dhembshuri:
Ofshan e ngryset krejt prej dëshpërimit
E derdh rrebeshe lotësh me furi,

Pastaj sërishmi çelet, lumtërohet,
Në sytë e kaltër gazi prap i ndrin;
Nga gjijtë e saj një afsh i ngrohtë çohet
Dhe jetën anëmbanë përtërin.

Pranverë, plot harbime e vrulle prore,
Sa ngjan ti me pasionet dashurore!

1962

* * *

Petalet bien; era mengadalë
I hedh mbi gjurmat, që lë mikja pas.
E shoh tek shkon e heshtur dhe një fjalë,
Për lamtumirë, s'kam fuqi t'ia flas.

E ç'mund t'i them? Dëgjon të kthehet vallë
Sërishmi zogu, që mërgimin nis,
Kur tjetër vis kërkon e s'e zë malli
Për çerdhen a për strehën që braktis?

Papritur, të rrëmbyera rrëkera
Në shpirt më mbysin dhembjen pa kufi!
Petalet bien. . . heshtas shket pranvera,

Roniten të përkohëshmet stoli. . .
Një grusht kujtimesh që shpërndau era,
Ja ç'qe, së fundi, gjithë kjo dashuri!

1962

K U K Ë Z A

Prej vitesh kjo «ku-ku», «ku-ku»,
Gjer thellë më kumbon;
Ku je ti shpend i fshehtë, ku
Me kaqe shpirt këndon?

Ç'kërkon ti vallë e s'e gjen dot
Në botën e pafund,
Që këtë klithmë përngamot
Ti s'e pushon, gjëkund?

Në t'artën mituri dikur,
Kujtoja se kështu,
Ti pyll më pyll e gur mbi gur
Kërkoje prindt' e tu.

Ndër ato vite plot me zjarr,
O motër, porsi ti,

Dhe unë mbeta vetmitar
Mes rrugësh, pa njeri.

Pas thirrjes sate, në çdo kënd
Baritja papushim,
Se doja që me mallin tënd
Të ndaja mallin tim.

Prandaj dhe sot, kur të dëgjoj,
Rrëqethem përsëri
Dhe rend si foshnjë e të kërkoj
Në pyjet, ku rri ti.

Prandaj gjithmonë kjo «ku-ku»,
Gjer thellë më kumbon...
Ku je ti shpend i fshehtë, ku
Me kaqe shpirt këndon?

1962

* * *

Kushtuar P. J.

O mik i shtrenjtë! Shkuan kaqe vjetë,
Po ty nga shpirti dhembja nuk t'u nda;
S'të qeshi buza, qysh nga ditë e shkretë
Kur një syzezë iku dhe të la.

Po pse, i dashur, vitet që na shkuan
Me brengë t'i kujtojmë e me mërzi,
Kur ne me gjithë zemër ia kushtuam
Çdo hov rinor së dlires bukuri?

Në vitet tona, s'duhet ta gënjejmë
Me lotë shpirtin, se s'ia vlen, vëlla,
Që dashurinë e vogël ta shpërblejmë,
Kështu si ti, me dhembje të mëdha!

1963

J E T A

Mbi tokë jeta kurrë nuk mbaron, —
Ajo gjithnjë lulzon e përtëritet.
Bri lisit, që sa vijnë e krrusin vitet,
Filizi i ri nis rritet e bleron.

Dhe nëse shqotë e kohës lisiin plak
E than, ne s'themi: jetë e tij mbaroi:
Ajo, nga rrënjë e lisit-at, kaloi
Te rrënja e re e lisit-bir njomzak.

Kjo ndodh edhe me njerëzit mbi dhé:
Fëmijët tanë, nipat, përtëritin
Fuqinë tonë, ndjenjat, gjakun, shpirtin, —
Edhe ndër ta sërish jetojmë ne.

Legjendë vetëm është vdekja jonë.
Se jeta s'ka mbarim, po rrjedh gjithmonë.

1963

* * *

Sa pisk e kam, sa dhembje ndjej, sa dua
Të më përpijë brenda dheu i zi!
Oh, zgjate dorën sonte edhe mbi mua,
Të ngrohtën dorë, o mëma Shqipëri!

Jam i sëmurë, buza po më dridhet,
Këtu në gjoks diçka më çpon, si gjemb,
Një lëmsh, nj'i fortë xhung në fyt më mblidhet,
S'marr frymë dot, çdo pejz në trup më dhemb.

Një çast më merr në gjirin tënd të shenjtë
Të mbështes kryet e të qaj, të qaj,
Ashtu siç mund të qajnë, o mëmë e shtrenjtë,
Veç foshnjat dhe fajtorët e pafaj!

1964

* * *

Dy hapa harg, e vite për t'arritur
Atje, ku për çdo çast na vete malli,
Atje, ku bujarisht fal jetën diell' i ndritur,
Atje, ku po na qajnë për së gjalli.

Dy hapa larg, vëlla, dy hapa larg, matanë
Pas mureve të lagësht e të errët,
Po na vajton liria, që prej saj na ndanë,
Sepse më fort e deshëm nga të tjerët.

1964

NATË PA KËNGË

Ah, s'di ku zvarritem kështu kuturu,
Pa dëshira, pa ëndrra, pa dhëmbje të dlira!
Në shpirt, si thëllime,
Më rrahin dyshime
Që ngrihen diku nga një det, ku dremit
nën kallkan fshehtësira.

Po në ç'mendje dhe shpirt nuk dremisin
mistere pa fund,

Që, kur zgjohen,
Tërbohen,
Si det prej stuhisë e buçimit,
Dhe vark' e mendimit
Mes dallgëve zhytet e humb?
Kush i tha vehtes njeri
Dhe kudoqë në shtigjet e jetës kaloi,

Kudoqë në qiejt e saj fluturoi,
A kudo nguli rrënjët: në baltë, në shkëmb
a mermer,
S'e zbrazti, të paktën një herë, në ankth e mërzi,
Ndonjë kupëz me vrer?

Po je ti Shpirt i këngës, që vjen fluturim
Nga hapsirat pa anë e mbarim
Edhe shkrihesh me tingujt, me rrezet e ngjyrat,
Me çdo bukuri që u shfaq syve tanë natyra,
Je ti që na sjell ëmbëlsi, dashuri
Dhe dëshira dhe vrulle të reja, pas vrerit,
Që mendjen dhe shpirtin s'i lë të fundosen
në det të misterit,
Po flatra të forta, që s'thyhen nga vrull' i
stuhisë,
Fshehtas u sjell,
Dhe i ngjit nëpër qiejt pa fund të gjenisë!

Ah, s'di ku zvarritem kështu kuturu,
Pa dëshira, pa ëndrra, pa dhëmbje të dlira!
Në shpirt, si thëllime,
Më rrahin dyshime
Që ngrihen diku nga një det, ku dremit
nën kallkan fshehtësira. . .

Shpirt, a demon i përbindshëm, s'po pyes
Po rrëmbemë këndeje nga të errëtat shpella kush je,
Dhe ngjitmë me gaz e hare
Kaltërsive të thella,
Ku ti,
Përmbi valët e kohrave endesh në pafundësi!

Ah, s'di ku zvarritem kështu kuturu. . .

1965



* * *

Të le shëndenë, o shok, o mik, që thellë
Për mua pate ndjerë dhembshuri!
Nuk dua helm kjo vjershë të të sjellë,
Kur vetë po e shkruaj në qetsi.

Përse po ngre sot dorë kundër vetes?
Nuk di në ç'hon i shpresës yll më ra.
Kam mbetur n'udhëkryq e shtegu i jetës
S'kuptoj nga cila anë nis, or vlla!

Mistere të panumërta në kokë
M'u mblodhën e s'po di se nga t'ia mbaj;
S'më mbetet veçse me të ftohtën tokë
Morinë e të fshehtave ta ndaj.

Ti mos kërko t'i dish këto mistere
Të lutem veç, me duf, me shpirt, me zjarr,
Të më kujtosh për mirë edhe aherë,
Kur të më kalbet kryqi. . . mbi varr!

1965

* * *

Në tetor, kur prarohen korijet,
Nëpër trup një rrëqethje më shkon;
Shkrifem krejt e i ngjaj një fëmije,
Që m'i vogli ngacmim e trishton.

Nis kujtoj e të hidhurit lot
Nuk gjej forca në shpirt t'i përmbaj. . .
Si s'e kam një të afërm në botë,
Që me të gjithë dertet t'i ndaj!

Kujt t'i flas? Kush për mua kujtohet?
Shokët? Mikja, që n'epshe pa mend,
Tek në gjoks të një tjetri shtrëngohet,
Imrin tim në kllapi veç përmend?

Oh, sa dridhem, pa dashur gjith' jeta
Më fanitet plot dallgë e stuhi! . . .
Dhe çuditem me veten, si mbeta
Kaq i brishtë në shpirt, kaq fëmi!

1966

* * *

Pse ke zgjedhur natën, more i ngrati gjon,
Për këto gjëmime kaq me dhembshuri?
Natën është heshtje, gjindja të dëgjon, —
Vallë, a ia ka ngenë brengës që ke ti?

Vallë, a ia ka ngenë. . . vallë, a të merr vesh?
Kjo të bën të plasësh, gjon, o gjon vëllai!
Ngushëllim për dhembjet ku kërkon të gjesh?
Ik, merr tutje pyllin, zër një skutë e qaj!

1966

* * *

Ne duheshim si pjergulla me plepin,
Po nëna, që s'na desh,
Rrufenë e zemërimit erdh e shkrep
Një ditë midis nesh.

Ahere ajo u zbeh, u bë si ftua,
Në sy s'i mbet më zjarr;
«Do bëhem qyqë, i dashur, — m'u betua, —
Dhe tjetërkënd s'do marr!»

N'atë hutim, ku befas kisha rënë,
Mbaj mend, e humba krejt,
Por, duhet që patjetër t'i kem thënë
Të më harrojë shpejt,

Dhe në më hastë rrugëve të jetës,
Si shtegëtar të mjerë,
Ashtu siç katandisen veç poetët,
As sytë mos m'i shtjerë!

1967

* * *

Përpara se me britmën e çjerrë dhe të ashpër
Të përshëndesja botën një nate në tetor,
Kur isha n'ëndërrimet e prindërve të varfër,
Kam qenë djalë i lumtur e gazmor.

Më këmbë e çaja detin, kështjella ngreja n'erë
Dhe as e vrisja mendjen për art e poezi,
A për gjahtarë ëndrrash, hetues e kapterë,
Që dinë veç kanune dhe qeli.

Oh, gjithë ç'desha i kisha dhe isha zot i vetes,
Të bukura syzeza më vinin rrotull plot,
Por s'ishte midis tyre ajo, që vetëm derte
Në zemër më ka sjellë deri sot.

Prandaj dhe s'më zë malli të kthehem n'atë jetë:
Këtu, në mos më shumë, të paktën, e shikoj
Atë, që më ka sjellë në zemër vetëm derte,
Që si më ka magjepsur, s'e kuptoj.

1967

* * *

Unë ngjaj me bredhat nëpër male,
Që të bletë mbeten në çdo stinë,
Që nuk ka ç'u bën acar' i egër
Me dëborë e shi e suferinë.

Ajr, i pastër, trualli i fortë
Vallë u jep atyre kaq rini?
Ku ta dish: natyra ka dhe ligje,
Që prej nesh i fsheh me xhelozë.

Unë ngjaj me bredhat, por. në dimër,
Tek mbi supe borën pres i heshtur,
Mendja më rri larg te një qershizë,
Që acar' i ngrirë e gjen të zhveshur...

1967

* * *

Oh, ç'natë! Prej tokës së thelli,
Një hymn i mahnitshëm ushton
E çan madhështor nëpër qiellin,
Ku hëna me retë vallzon.

Dhe pishat me mall përqafojnë
Fënerët e rrugës kudo;
Të dehura hijet lodrojnë
Dhe dridhen e puthen nën to.

Pas tyre dikur, si fëmijë,
Me mikën në rendim me vrap
E ndalnim t'i kapnim, po hijet
Na shkisin e putheshin prap.

Nuk di për sa kohë vazhduam
Të rendnim ashtu plot hare,
As di si pastaj u bashkuam
Me lodrën e tyre dhe ne.

Mbaj mend vetëm fjalët që shkanë
Aq ëmbël nga buzët e saj:
«I dashur, veç ty të kem pranë,
Pa jeta rrjedh vetë pastaj. . .»

Dhe nata, e bukura natë,
Ushtimën pushoi rreth nesh;
Kështu si tani, hënë e artë
U fsheh edhe humbi pas resh.

Po ne ku u zhdukëm, ku humbëm
Aq keq, sa mos shiheshim dot?
Sa më njeri tjetrin s'po mundim
Ta gjejmë gjëkund dhe sot?

1968

* * *

Mban mend? Kësaj rruge dolëm
Natën e lamtumirës.
Fjalët, që dot nuk i folëm,
Shiu ia tha errësirës.

S'di sonte këndeje si kalova,
Kohët si lash mënjanë;
Befas m'u duk se dëgjova
Dy zëra, si zërat tanë:

Njëri diç foli për mallin,
Tjetri sikur psherëtiu. . .
E dashur, ne ishim vallë,
Apo errësira dhe shiu?

1970

* * *

Një mbrëmje si kjo tek shëtisnim,
N'agim të rinisë të dy,
Nga turpi i puthjes s'guxonim të flisnim,
Nuk shiheshim dot në sy.

Po sot, pas kaq viteve ndarë,
Kur hasemi rrugës të dy.
A thua nga turpi i puthjes së parë
S'u shihkemi dot në sy?

1971

* * *

Kur m'erdhi ajo në dhomëzën e thjeshtë,
Nga brishtësi' e saj,
M'u derdh papritur gjithë freski' e vjeshtës
Dhe ndjeva të rrënqethura. Pastaj...
Pastaj, përtej dritareve të dhomës,
Me kryet ulur nga puhiza e lehtë,
Mes kopështit diku, qershiza e njomë
Plot hijeshi filloi e lëshoi fletët.

1972

* * *

Tokë e ëmbël,
Tokë e shtrenjtë e mëmëdheut tim,
Ti sikur je veshur me një ëndërr,
Aqsa syri zor se bën dallim
Ku në ty fillojnë e ku mbarojnë
Caqet e legjendës! Nuk e di,
Po dhe flladet, lehtas tek kalojnë,
Sikur i magjeps diçka tek ti,
E sikur papritur mërmërisin,
Me të blerta fjalë gjeth më gjeth,
Vargje rapsodish që të mahnisin,
Po kur zgjohem unë e bëj t'i mbledh,
Ato ikin larg e fluturojnë,
Larg, ku s'kopen dot. . . O mëmëdhe,
Mbase veç fëmijtë e ngatërojnë
Jetën me legjendën. . . Po nga ne,

Ç'është ai që s'ndihet krejt fëmijë
Para teje e nuk të pëshpërit
Çuçurima t'ëmbra dashurie,
Mbase miturake, po me shpirt?

1976

* * *

Mbi trëndafilin flutura qëndroi,
Po mikja, kur e pa,
«Më sakatove, ç'bën kështu?» — më tha
Dhe njollëzën te buza më tregoi.

S'e desha vehten, se ku dija ahere
Që faje kësisoj në prill të moshës falen,
Se trëndafilat ndaj lulzojnë e lëshojnë erë,
Që fluturat mbi ta të ndalen.

1977

KËNGA E SHEMO KASOS

Maleve përtej në Samarinë.
Shemo Kasua bashnizamët korr.
Pik e helm valiu i Janinës
Vrerin seç e derdhi mbi tabor:

«Ja ma bini lidhur, — tha, — gjaurin,
Ja me këtë pallë do t'ju grij!»
Gjarpërin nën gur e vetë gurin
Ç'i tromaksi ulërim' e tij.

Një motmot firarit pas i ranë.
S'lanë shkrep pa shkelur e livadh,
Po shkëlqimn' e kordhës vec i panë,
Tek i korrote e shkiste si sorkadh.

I dërgon që larg e shoqja fjalë:
«Si do rriten djemtë, a ditëzi?»
«Me rradiqe e me lëpjetë mali,
Siç jam rritur vetë!» — i thotë ai.

Papo na i dërgon pashai fjalë:
«N'u dorzofsh, të bëra kumandar!»
«Def, — ia ktheu Shemua, — se s'kam dalë
Për ofiqe maleve firar!»

Dhanë e morën, më në fund e zunë.
Ç'u habit valiu kur e pa!
«Bjer, — i tha, — firar, këtu më gjunjë!»
Po më gjunjë Shemua nuk i ra!

Shfryn valiu: «Ja ta ula hundën,
Ja në hell të shkova porsì dash!»
«Shkomë, — i thotë trimi, — dhe **po**
munde,
Zemrën time për mezé ta ndash!»

Siç u tha, u bë... Më pas u ndalën
T'i kërkonin zemrën, po më kot:
Zemra zog që bërë e nëpër male
Fluturonte e fluturon dhe sot.

1980

* * *

Ah, nën këto akasje të thara krejt pothua,
Ka vitë e s'më kujtohet si ndodhi që papritur
Ajo pa vetëm qiell e degë përmbi mua
Dhe unë, bar, nën flokët e saj të shpupuritur.
Mbaj mend që u ngrit një thirrje e s'di ku
humbi,

Pastaj dy zogj që ranë diku nga një fole
Edhe një erë mali, që erdh e befas shkundi
Dëborën e petaleve mbi ne. . .

1984

* * *

Gëzima' e dashurisë syzezës a sykaltrës
Ia falim krejt, asgjë për vete s'mbajmë;
Zhgënjimn' e dashurisë me mikun më të afërt
Mundohemi vëllazërisht ta ndajmë;
Kurse kujtimn' e saj e fshehim diku thellë,
Porsi kopraci i prallave thesarin,
Dhe kyçim dyert mirë kur vemi e përkëdhelim,
Se trembemi mos vijnë e na e marrin.

1984

* * *

Mëdet se ç'hall i madh më gjeti:
Nuk e kuptoj se ç'është kjo,
Që s'po arrij ta njoh dot veten,
Kur jam në ëndërr e kur jo!

M'u bë sikur, tani dhe dridhem,
Kaq e tmerruar ëndërr qe,
M'u bë sikur një short i hidhur
Na ra për pjesë e sikur ne,

Që mezi ç'presim për t'u parë,
Se si u grindën krejt pa shkak
Dhe mbetëm, për habi, të ndarë
Një çerek shekulli, jo pak!

Duro e tkurru e shkreta zemër
Thash se do më ngurosej shpejt,
Po befas ti më thirre n'emër
Dhe brofa i shastisur krejt,

Sa s'munda ta kuptoja fare
Dhe s'e kuptoj dot as tani,
Kush ishte ëndërr, ajo ndarje,
Apo ky zgjim plot lumtëri?

1986

DIELLI DHE VLAGA

Një djalosh si drita na takuan,
Duke shkuar rrugës, tri syzeza;
Dhe të tria befas fërgëlluan,
Fshehtas njëra-tjetrës, flakë u ndezën.

Thotë e para: «Nga na vjen, or djalë?»
«Ç'erë të ka sjellë?» — ia kthen e dyta.
Më së voglës lëmsh iu mblodhën fjalët,
Pati turp e nuk i ngriti sytë.

«Unë jam, — tha djali, — vetë dielli.
Ç'erë më ka sjellë? Dashuria.
Zbrita fluturim nga kupa e qiellit,
Të marr nuse një nga ju të tria!»

Flet e para: «Po më zgjodhe mua,
Bëhem hije, të flladis me erë!»
Hidhet tjetra: «Unë bëhem krua,
Të të shuaj zjarrin përngaherë!»

Më e vogla prap nuk flet, e gjora,
Flakë s'është e digjet porsi flakë,
Borë s'është e befas, porsi bora,
Shkrihet e i bëhet tokës vlagë.

Mbetet i habitur djali—diell:
Qysh u zhduk kjo vajzë kaq papritur?
E kërkon gjithkund e nëpër qiell,
Më së fundi, ngjitet i mërzhitur.

Thuhet se dhe sot, pas kaqe kohe,
Sytë i hedh ai nga lartësitë
Gjithë mall mbi tokë, se mos shohë
Vashëzën e dashur ndonjë ditë.

Papo thuhet edhe se syzeza,
Sakrirë e bërë vlagë e thellësive,
Sapo ndien mbi dhé të parat rreze,
Zjarrin e të gjitha dashurive,

Del e bëhet vesë e ndrin, e gjora,
Mbi kurora lulesh e mbi fletë...
Vashëza, që shkriu porsi bora,
Vlaga e thellë e tokës, jeta vetë.

1988

* * *

Krahët e xhamtë ka shtrirë
Cikna mbi grykat e pyjet.
Hëna rri pezull e ngrirë,
Grimca prej akulli, yjet.

Duket përreth sikur jeta
Befas ka humbur çdo gjurmë;
Vetëm, nën akuj, rrëketë
Prap gurgullojnë me zhurmë...

1989

VRESHTI I POEZISË

L. Poradecit

«Naimi preu shkurret, shkuli ferrat,
Pastaj qilizmë truallin punoi;
Fidanët mbollën me durim të tjerët
Dhe vreshti i bukur shpatin gjelbëroi.
Kur vajta unë atje. — më tha Lazgushi,
Një mbrëmje buzë gjolit tek shëtisnim, —
Hardhitë kishin lidhur vile rrushi,
Por, kemi etje! dukej sikur flisnin.
Ahere ç'bëra? Nëpër shkëmb të malit,
Një brazdë hapa deri te burimet
Dhe më së fundi, ujrat si kristali
U derdhën nëpër të me mërmërimë.»

Si tha këto, mbështeti të dy duart
Përmbi bastun, dhe shtoi si nëpër lotë:
«E keni radhën ju për ta punuar

Këtë të bukur vresht, pa shok në botë,
Ta rritni të shëndetshëm, ta selitni,
Ta doni si thesarin më me vlerë;
Dhe neve, që aty e lamë shpirtin,
Na sillni nëpër mend ngandonjëherë!

1989

PLAKU I URËS

Qëmoti, thonë, te një urë e gurtë,
Tre vetë deshën t'iknin nga kjo botë.
Por ua kuptoka mendjen një i urtë:
«Ç'e keqe ju ka gjetur?» — vjen u thotë.

Ia kthën m'i riu: «Miken që më deshi,
Një tjetri sot ia shpien me dasmorë. . .»
«Ja ti shpëtove, — foli plaku e qeshi, —
Po kur të marrë vesh ajo e gjora
Ç'ia gjeti mikun, pika mund t'i bjerë.
Nuk t'ardhka pakëz keq?» Ky mbeti shtangur
Dhe në mendime ra një copëz herë,
Pastaj u ngrit e shkoi nga kish ardhur.

I vjen të dytit radha: «Mos më pyet!
Lirinë humba e kot që rroj në botë!» —
Rënkon së thelli ky, pa ngritur kryet.

«Po nuk ke humbur jetën! — plaku i thotë. —
Dhe kur ke jetën, ke një lumë gjaku,
Paguaje me çmim të tij lirinë!»
U bind dhe ky nga fjalët që tha plaku,
La urën pas e humbi në luginë.

I treti fillikat mbi urë mbeti.
Nga pamja e vrarë, dukej më i mjeri.
«Po ty, — i flet i urti, — ç'hall të gjeti?»
Ai mezi përgjigjet: «Humba nderin...»
Dhe seç kërkon të shtojë nëpër dhëmbë,
Po nuk e lënë drithmat edhe lotët.
Ahere plaku merr një gur të rëndë,
Ia var në qafë e «Mos e zgjat!» — i thotë.
«Mos është i ftohtë uji...» — mërmëriti,
Tek dridhej tjetri, por nga buza shkau!
Dhe s'tha njeri për të: «I ndrittë shpirti!»
As lumi që e mori nuk e qau.

1989

VALLJA E OSMAN TAKËS

Eh, mor Osman Taka,
Bir, Osman, me halle!
Vetëtin me kordhë,
Shkrepëtin me valle!

Ngrihesh si shqiponjë,
Bie si fajkua,
Papo shkel mbi truall,
Si sorkadh mbi thua,

Sikur do të thuash:
«Ka barut kjo tokë;
Rëndë po ta shkelësh,
Bën shaka me kokë!»

«Ç'bën ky rrënjëdalë, —
Turfullon valiu, —
Ç'e pandeh litarin?
Lodër çilimiu?»

Rreptas ti përdridhesh,
Porsi shakull ere!
Ç'i kujton halldupit
Pritat e limeret,

Pritat e asqerët,
Prerë e grirë strallit...
Hijen e mehitit
Ç'i vërvite ballit!

Eh, mor Osman Taka,
Bir, Osman me halle,
Një pasha dovleti
Vrave me një valle!

1989

* * *

Një mbrëmje, për t'u çlodhur, kisha dalë
E po shëtisja bregut mengadalë.

Nga njëri krah, sodisja perëndimin,
Nga tjetri, nëpër rërë, hijen time.

Ajo u zgjat, u zgjat, e më së fundi,
Me muzgun befas njësh u bë dhe humbi.

Nuk di ç'm'u shkrep një çast e ndala hapat
Të shihja ç'gjurmë kisha lënë prapa.

Por kot i hodha sytë nëpër rërë:
Në muzgun gri që kredhur bregu i tërë.

Se si më shkoi një dridhje e thash me vete:
Si lum ai, që në mëngjes të jetës,

E sjell ndërmend dhe mbrëmjen herë a herë
Dhe s'u gëzohet hijeve pa vlerë,

Po rreh të lerë gjurmë drite prapa,
Të shohë nëpër ç'rrugë i hodhi hapat...

1989

* * *

Eja, kënga ime, s'kemi ç'rrimë
Mes kësaj rrëmuje pa kuptim,
Vrasësi ku hiqet për viktimë
Dhe viktimës i kërkon shpagim,
Ku të përdhunuarat gjykohen,
Me të rrugës ligj, nga prostitutat,
Ku të marrë e t'urtë përgojohen
Dhe servilët, porsi minj nga skutat,
Dalin rrahin gjokset edhe mburren
Se luftuan vrimash, si heronjtë,
Kuajve të ngordhur tek u sulen
Për t'u hequr me tërbim patkonjtë....
Ku gjithkushi klith e shfryn paprerë,
Me një duf që, mëshirona o zot!
Eja, këngë e dashur, kaq poterë
Unë e ti nuk e durojmë dot,

Se jo pakëz jeta na ka vrarë...
Ndaj le t'ikim, ku s'na sheh njeri!
Mbase larg në pyjet magjistare
Do të gjejmë prehje dhe qetsi.

1991

* * *

Këndeje armik, andej edhe më zi,
Edhe në gjoks, edhe në shpinë plumba.
Kurse, me klithma, nëpër qiellin gri
Përplasin flatrat tufa me pëllumba,
Pa ditur nga t'ia mbajnë... Eh, o njerëz!
Ç'e paskeni kaq mlllef për njeri tjetrin?
Një çast duroni, veç një grimëz herë
Pushojeni këtë orgji të egër,
Të paktën, gjersa në të tjera vise
Të çajnë e t'ikin, mbase përgjithmonë,
Këta të mjerë zogj të dashurisë.
Që i tromaksi çmenduria jonë!

1992

* * *

Ç'po më trishtoka ky kavak i zhveshur,
Plot çerdhe të braktisura, të shkreta!
Veriu i ftohtë fryn mbi të pareshtur,
Kurse dikur, ndër degët plot me fletë,
Puhitë i përkëdheleshin gazmore,
Dhe tufa zogjsh i vinin rreth kurorës,
Me çirra e cicërime gjithë jetë.
Po si s'na shkonte nëpër mend ahëre,
Që ato trumba shpirtrash fluturakë
Këtu e kishin strehën gjithë herës,
Në kraharorin e këtij kavaku?
Si ndodh kështu? Pse vallë u dashka pritur
Gjersa të zhvishen drurët, për të parë
Sa çerdhe kish ndër ta?... Medet, nga vitet,
Një radhë «Pse?» më ngrihen gardh përpara,

Që bëj t'u jap përgjigje, po s'arrij.
Dhe ndihem i braktisur, zemërvrarë,
Si ky kavak, në shkretëtinë e tij.

1992

* * *

S'i mbaj mëri për vitet e rinisë,
Që një nga një po m'ikin pa gëzim,
As jetës plot andrralla, as dashurisë,
Që u tall ashtu siç desh me fatin tim.

Askënd nuk e kujtoj për keq në botë, —
Në zemrën time shteg të mbyllur s'ka:
Mjafton një fjalë e çiltër, fjalë e ngrohtë,
Që të më bësh prap mik e prap vëlla.

1967

STACHSBERG

NGA POEZIA KINEZE

DU FU

P A P A G A L L I

Papagalli ka në kokë
Ca të dhembshura mendime;
Është i mençur edhe ruan,
Nga e shkuara, kujtime.

Pendët i janë shkurtuar,
Flatrat seç i kanë rënë;
Shumë fjalë ka mësuar,
Po jo fjalë për të qenë.

T'i shpëtojë robërisë
Ai rri e pret çdo çast.
Njerëzit atë e duan,
Veç e mbyllin në kafaz.

Dhe atje në pyll, një degëz
 Mbeti fillja në shkreti, —
 E ç'i duhet papagallit
 Vallë bukuri' e tij?

SKIFTERI

Dëgjoj fërfërimën e fletve, kur dridhet i bardhi
mëndafsh, —
Kaq bukur një dorë artisti skifterin ç'e ka
pikturuar, —
Si t'ish egërsirë e brengosur, i mvrejtur
vështron e gjithë afsh,
Thonjtë përpjetë ka ngritur, të turret mbi zogj
i tërbuar.

Të ngjan se me etje pas gjahut po niset tani
fluturim
Dhe shpirti i luftës përbrenda me duf po i nis
t'i gjëmojë,
A thua vërtet do të turret mbi tufën me zogj me
tërbim
Dhe fushën pa fund e pa anë me pendë e me
gjak do mbulojë.

PATA E EGËR

Patë e egër vetmitare
Nuk po ha dhe nuk po pi;
Fluturon e nuk gjen strehë,
Klith me brengë e dhembshuri.

Shtegëtaren që ka mbetur,
Cila tufëz vallë e pret,
Kur të gjitha kanë humbur
Njëra-tjetrën nëpër retë?

Patës s'egër seç i duket
Sikur rishmëzi dëgjon
Tufëzën e saj të dashur,
Që në gji të vet e fton.

Porse veç një korb i çmendur,
Gjithë i zyrtë dhe i shkretë,
Klith me tmerr tani mbi fushë
Dhe përpjek të zezat fletë.

M A R G A R I T A R Ë T

Seç më erdh një mik i largët,
Që prej shtatë deteve;
Më dhuroi margaritarë —
Lotëzit e nimfave.

Dhe këta margaritarë
Kishin shenja e shkronja plot;
Ç'u mundova t'i kuptoja,
Po nuk ia arrita dot.

Në një shportëzë bambuje
Seç i vura që t'i ruaj,
Kur të vijë taksidari.
Me to tagrën të paguaj.

Por papritur kjo dhuratë
Pika gjaku seç u bë...
Erdhi rishmëz varfëria
Pranë meje, si gjithnjë.

NGA POEZIA PERSIANE

XH. RUMI

HARDHIA E EGËR

Jam një hardhi e egër, të tillë e pata fatin,
Ti bëmu panjë e bardhë, që të të vij rreth
shtatit!

Jam dredhëz shermasheku, ti bëmu pishë e
bukur,
Të kem se ku të qepem, mos ndehem nëpër
pluhur!

Jam fluturak i drojtur, ti bëmu e fortë flatër,
Të kridhem në hapsirat e qiellit tënd të kaltër!

Jam një dori i lodhur, ti bëmu shpore e çpomë,
Tek ti, nga largësiat, revan të vij gjithmonë!

Jam një vulla i shkrifët, ti trëndafil harlisu
Në gjoksín tim, që vlagën të mos ma thithin
krisjet!

Jam mugëtira e lindjes, ti dil që nga humnerat
E mjegullat shpërndami, si dielli, përngahera!

Jam nata e pahënë, oh, vello yjsh pa numër
Ti bëmu, të mos trembem e të marr frymë i
lumtur!

M. SAADI

PIKËZA E SHIUT

Pikëza e shiut ra që lart nga retë
Mbi një kreshhtë dallge mu në mes të detit.

«Si do bëj, e mjera, — zu të psherëti. —
Kjo humnerë e egër do të më përpijë!»

Po molusku vajti me gjak e mbuloi,
Pikëzës mes dallgësh jetën i shpëtoi.

Dhe tani që deti ujrat ka ndërruar,
Atë e ka Shahu perlën më të çmuar.

NGA POEZIA RUSE

A. S. PUSHKIN

I BURGOSURI

Lëngoju pas kafazit në burgun e zi.
Një shkabëz robinjë përballë më rri;
E ngrysur vështrimin ndër qieje vërvit,
Tund krahët dhe gjellën e gjaktë skërmit,

E shqyen, e flak dhe më sheh me trishtim,
Sikur kemi bashkë të njëjtin mendim.
Më grish me vështrime dhe zjen e këlthet,
«Të nisemi, — thotë, — ku qielli thërret!»

Ne jemi dy zogj, pa liri s'rrojmë dot!
Mbi male, vëlla, të vërsulemi tok,
Mbi detet e kaltër, të çiltër si lot,
Ku era dhe unë harbojmë ngamot!»

KARROCA E JETËS

Karroca e jetës ecën shpejt,
Sidoqë është e ngarkuar,
Dhe karrocieri, Koha vetë,
As ndalet kund për të pushuar.

N'agim, me gaz ne udhëtojmë,
Dhe kokën s'pyesim se lëmë,
Përtesën, dhelet i përçmojmë,
Bërtasim: jepi, ç'i!

Po në mesditë, të kapitur,
E mbledhim veten, kemi frikë
Çdo proshkë e gropë të papritur;
Thërrasim: më ngadalë, o mik!

Karroca rend. Në mbrëmje vonë,
Mbi të dremisim ne të heshtur,
Gjersa arrijmë strehën tonë...
Dhe Koha kuajt nget pareshtur.

A. P. KERNËS

Kujtoj me mall një çast gëzimi:
Përpara sysh m'u shfaqe ti,
Si vezullim i një vegimi,
Si engjëll plot me bukuri.

N'andralla jete zhurmë-kote,
Në dhembje brengash e mërzi,
Më grishte larg fytyra jote
Dhe zëri yt plot ëmbëlsi.

Nga shqotë e kohrave që shkuan,
Kështjellë e ëndrrave m'u shëmb.
Me mjegull vitet ma mbuluan
Fytyrën tënde, zërin tënd.

Ç'i ngrysa ditët gjithë brengë,
I zyrtë dhe në shkretëti,
Pa perëndi, pa shpresë e këngë,
Pa lotë, jetë e dashuri.

Po ja tek shkrepri prap agimi,
Se përsëri m'u shfaqe ti,
Si vezullim i një vegimi,
Si engjëll plot me bukuri.

Dhe rreh me gaz kjo zemra ime,
Sepse iu kthyen përsëri
Dhe perëndi, dhe frymëzime,
Dhe lotë, jetë e dashuri!

MBRËMJE DIMRI

Shqota qiellin e ka nxirë,
Shtyn dëborën me furi,
Herë shfryn si egërsirë,
Herë qan si një fëmi,
Herë mbi çatitë tona
Nis papritur e buçet,
Herë, si udhtar i vonë,
Në dritare na troket.

Hata (1) ime, e vjetra hatë,
Kredhur fle në terr të zi.
Po ti pse, ti pse, moj dado,
Te dritarja heshtur rri?
Bubullima gjithë gjëmë
Vallë zemrën ta mundon,
Apo përmbi furkën tënde
Ti dremit e ëndërron?

Eja pimë, o shoqe e shtrenjtë
E së shkretës djalëri!
Sillna gotat sa më shpejtë, —
Ndoshta lehtësohemi!
Më këndo për zogn' e shkretë,
Që në det diku jeton,
Dhe për vashën këmbëlehtë,
Që n'agim për ujë shkon!

Shqota qiellin ka nxirë,
Shtyn dëborën me furi,
Herë shfryn si egërsirë,
Herë qan si një fëmi.
Eja pimë, o shoqe e shtrenjtë
E së shkretës djalëri!
Mbushna gotat sa më shpejtë,
Ndoshta lehtësohemi!

1) hatë — shtëpizë.

SA JU KAM DASHUR!

Sa ju kam dashur! Ndoshta dashuria
Nuk është shuar krejt në shpirtin tim!
Po s'dua që prej dhembjeve të mia
Të ngryseni sërish në dëshpërim.

I heshtur e pa shpresë u përvëlova,
Me drojtje, xhelozë dhe mall për ju.
Po kaq me dëshirë ju dashurova,
Sa, zot! ju dashtë tjetërkush kështu!

KËNGA E ZEMFIRËS

(Nga poema «Ciganët»)

Burrë i tmerrshëm e plak,
Thermë sot, digjmë sot:
S'ta kam frikën aspak,
Mos kërcit dhëmbët kot.
S'të shoh dot, të përçmoj,
Ti urrejtjen më ndez.
Tjetërkënd dashuroj, —
Duke puthur do vdes!
S'ta kam frikën aspak,
S'të tregoj ty asgjë.
Burrë i tmerrshëm e plak,
S'e ke njohur atë:
As pranvera freski
Dhe as vera s'ka zjarr
Sa ai trim i ri.

Që më do gjer në varr!
Mbrëmë brodhëm të dy
Nëpër fushë, gjer larg,
Dhe u tallëm me ty,
Mor i thinjuri plak!

A. BLOK

ZOGU I RRALLË

Troket ngadalë. Më fort pas pakëz.
Pastaj më vjen
Një kukurisje e këndshme, e tingullt,
Dhe zemra zjen.
Pse heq e vuan
Shtëpia ime, —
Si s'e kuptoj?
Dhe këtij zogu
T'ia hap dritaren,
Pse po nguroj?
Ç'ëndërr shoh vallë
Brenda qelisë,
Kur më këndon
Ky zog i rrallë?
Tutje qelisë,
Për ku më fton?

S. ESENIN

ERA E DËBORËS

Erë, er' e dëborës, moj erë,
Merrmi vitet në krahët e tu!
Dua djalë të jem dhe një herë,
Apo lule luginës diku.

Nën një fyell bariu plot dhembje,
Dua sytë t'i mbyll në harrim:
Zile yjesh, me borën e mbrëmjes,
Të më bien në vesh pa pushim.

Oh, sa bukur e dredh ajo këngën,
Në tufan dëshpërimin kur derdh!
Do të desha diku, me një këmbë,
Ndanë rrugës të rrija, si bredh.

Ujehet njëkta ndosi
tote aset mburshur janë plot
i shkelim udhëtove dhe shohim
sa ofrimtoje, sa kalapat shkeltojnë

Hingëllima në terr kur të ndieja,
Të pushtoja kaçubën përbri...
Zgjati putrat, o hënëz, drejt meje,
Merrmi brengat në qiell, tek ti!

PUTHMË, MOJ E DASHUR...

Puthmë, moj e dashur, puthmë,
Gjer në dhëmbje, gjer në gjak.
S'e duron dot ftohtësirën
Zemr' e ndezur zjarr e fiakë.

S'është kupa e përmbysur,
Mes gazmorëve, për ne.
Ti një gjë kupto, moj mike:
Veç një herë rron mbi dhe!

Shih, në mes të errësirës,
Hënën që shkëlqim vërshon;
Sikur t'ish një korb i verdhë,
Përmbi tokë fluturon.

Puthmë de! se kalbësia
Këngën time ma këndoi;
Ka të ngjarë, qielli sipër
Fundin tim parashikoi.

Eh, moj forcë që venitesh!
Do të vdes, kjo s'ka dyshim!
Vetëm dua t'i puth mikes
Buzët, gjer në fundin tim,

Që pa turp edhe pa drojtje,
Ëmbëlsisht kur t'ëndërroj,
Tok me shushurima vishnjesh,
«Jam e jotja» — të jehojë;

Që, si shkuma përmbi kupë,
Drita mos na shuhet ne.
Ndaj këndo, moj mikja ime:
Veç një herë rron mbi dhe!

MËSHTEKNA

Cullufeza jeshile,
I bardhi kraharuar,
Mështekn' e hollë, e brishtë,
Mbi pellg pse rri menduar?

Ç'të pëshpërin ty era
Dhe rëra ç'të zhurmon?
Mos krëhërin e hënës
Për flokët ëndërron?

Të gjelbërat mendime
Ç'trazim t'i ngryska vallë?
Në shushurimën tënde
Një brengë ndiej, një mall.

«Këtu, o mik i dashur, —
Më thotë ajo dhe fshan, —
Nën yjtë e natës sonte
Erdh qau një çoban.

Dhe hëna shtroi hijet,
Blerimin rreth ndriçoi....
Ah, gjunjët e zbuluar
Ai seç m'i pushtoi

Dhe, përmes shushurimash,
Më tha me zjarr në gji:
Shëndet, gjersa të kthehen
Kojrillat përsëri!»

PRAG MÛZGU

Shih, lumtëri budallaçka
Në kopsht nga dritaret shikon!
Heshtas mbi pellg perëndimi,
Si mjelmëz e kuqe pluskon.

Shëndet, qetësi e florinjte,
Plot hije gjithkund! Mbi çati,
Tuf' e laraskave roje
Yllit të mbrëmjes ç'i rri.

E drojtur, diku prapa kopshtit,
Kalina ku lulet harlis,
Një vashëz krejt në të bardha,
Ëmbël një kënge ia nis.

Dhe hapet, si rraso e kaltër
Mbi fushëz, e natës freski...
Eh, luntëri budallaçka,
Purpur i faqeve ti!

NJERIU I ZI

Ah, mik, o mik,
Jam shumë, shumë i vrarë.
S'e marr vesh nga m'u shpik kjo lëngatë
kështu.

S'e marr vesh,
Fishkëllin nëpër fushën pa jetë erë e marrë,
Apo mos, si gjethnaja në pyll,
Po më bie alkooli në tru.

Koka veshët m'i tund,
Siç i tund zogu flatrat:
Bën të ikë prej qafës,
S'duron dot aty.
Një i zi, një i zi,
Një njeri krejt i zi,

Sterrë i zi,
Vjen e m'ulet te shtrati,
Një njeri sterrë i zi
S'po më lë të mbyll sy.

Dhe ky sterrë njeri
Mban një libër të ndotur në duar.
Papo, krrusur mbi mua,
Si murg mbi dikë nën qefin,
Seç fillon më lexon
Për një palo rrugaç të mallkuar
Dhe në shpirt më kall tmerr e më ngrin.
Ky njeriu i zi,
Sterrë i zi!

«Pa dëgjo, pa dëgjo, —
Nis më thotë. —
Te ky libër ka plot

Ëndërrime dhe plane.
Ky njeri paska rrojtur
Në një vend të botës,
Ku harbojnë gjithkund sharlatanë.

Dhe, për dreq, n'atë vend
Ësht' e pastër dëborë e dhjetorit,
Papo qerthuj gazmorë
Sajojnë tufanet atje.
Ky njeri paska qenë
Ndër horrat, më horri,
Ndër ata që takohen,
Fort rrallë mbi dhé.

Ish i pashëm,
Madje dhe poet.
Mbase pak i fuqishëm,

Por që mbresë të linte në zemër;
Dhe ky quante vashëz fisnike,
Mikeshëz të vet,
Një dyzet e kusur vjeçe femër.

Mendje e shkathët dhe duar,
Ja ç'duhet. — thoshte ai. —
Shpirtrat e plogët janë fatzes gjithënjë.
Tjetërsohu me gjeste,
Ja ç'ka më fort rëndësi;
Do të vuash paksa,
Por, s'ka gjë!

Në shqotë e shtrëngatë.
Në thëllimet e jetës.
Ndër humbjet e rënda.
Kur mezi i mban lotët.
Të shtiresh i qeshur, i qetë,
Ja, ky është ç'fati më i lartë në botë!>

«O njeriu i zi!
Mos e zgjat, se durimi m'u sos!
Ti nuk je polumbar,
Ndaj të zhytesh më tej mos guxo!
As më duhet në qënkej dikur
Një poet skandaloz;
Gjej të tjerë e lexojua këto!»

Njeriu i zi
Më vështron gjithë krupë,
Sytë i bëhen jeshilë prej vrerit,
Sikur do të më thotë
Se s'jam veç kusar i paskrupull,
Që mendjen rri vras
Qysh t'i turrem, si brac, ndonjërit.

Ah, mik, o mik,
Jam shumë, shumë i vrarë.
S'e marr vesh nga m'u shpik kjo lëngatë
keshtu.
S'e marr vesh, fishkëllin
Nëpër fushën pa jetë erë e marrë,
Apo mos, si gjethnaja në pyll,
Më ka rënë alkooli në tru.

Nata, e akullt.
Hesht udhëkryqi tutje.
Vetëm fill po qëndroj në dritorez.
Mysafirë nuk pres të më vijnë.
Fusha, mbuluar me pluhur gëlqerje të butë,
Si kalorës mbi kuaj,
Drurët në kopësht po rrinë.

Diku qan një zog nate i harruar.
Po trokojnë kalorësit e drunjtë.
Pa u drojtur aspak,
Prap njeriu i zi
Vjen më rri në kolltuk i shpenguar,
Ngre cilindrin paksa,
Pastaj redingotin flak.

«Pa dëgjo, — më gërrhet
E më sheh në fytyrë,
Papo duke u përkulur,
M'afrohet më shumë. —
Batakçi të këtille
S'më ka zënë syri,
Që të vuajë kot
Për gjumë.

Ah, dhe mbase gabohem!
Por, ç'hënë përjashta! Vështro:
I dehuri vallë
Ç'dashka endë që të kotet?
Ndoshta, me kofshët e trasha,
Fshehtas të vjen «ajo»
Dhe ti do të rrish t'i lexosh
Ndonjë vjershë të mokus plot lot.

Milet i lezetshëm poetët!
I dua vërtet!
Pothuaj të gjithë
Të njëjtit avaz ia thonë:
Një kursantje, me puçërza ballit,
Një përbindësh me flokë të gjatë i flet
Për botra e botra,
Kapluar prej epshesh gjithmonë.

Na ishte dikur në një fshat,
S'më kujtohet tani,
Në një familje të thjeshtë fshatare,
Diku në Kalugë a Rjazan —
Nuk e di —
Një djalë sykaltër
E me flokët si ar...

Dhe ky djalë u rrit,
U bë dhe poet,
Mbase pak i fuqishëm,
Po mbresë të linte në zemër,
Dhe quante vashëz fisnike,
Mikeshëz të vet,
Një dyzet e kusur vjeçe femër.»

! O njeri stërrë i zi!
Mysafir shëmtarak!
Këtë nam e ke ti qysh prej kohësh,
Jo unë!
Mbushem me mllef,
Zemërohem, tërbohem
Dhe turinjve
Ia vesh me bastun...

Hëna vdiq.
Kaliëron në dritorez agimi.
Ah, moj natë, moj natë!
Ç'ishe sonte kështu kaq e zhgrryer?
Vetëm fill rri tani. me cilindër në kokë,
Në dhomëzën time.
Vetëm fill...
Me pasqyrën e thyer...

NGA POEZIA UKRAINASE

T. SHEVÇENKO

A M A N E T

Kur të vdes, të më mbuloni
Te ndonjë kodrinë,
Që ta shoh gjithnjë, vëllezër,
Mëmën Ukrainë;
Të vështroj, me gaz në zemër,
Fushën pa kufi,
Të vështroj si derdhet Dnjepri,
Si buçet ai,
Si vrapon mes Ukrainës
Drejt e për në det...
Do t'i lë mënjanë ahere
Fushat e rrëketë
Dhe do ngjitem lart në qiell,
Lart te perëndia,
T'i flas hapur e t'i qahem
Për dertet e mia.

Kur të më mbuloni mua,
Prangat flakini!
Derdheni në shesh të luftës
Gjakun, për liri!
Dhe në familjen e madhe,
Të re dhe të lirë,
Ma kujtoni fjalën time
T'urtë dhe të mirë!

NGA POEZIA POLAKE

J. TUVIM

D E G Ě Z A

Pse lëviz pa pushuar kjo degëz?
Pa mendohuni pak e më thoni!
(Era vallë këto shushurima
Po m'i sjell nga dritarja gjithmonë?)

Befas degëza trëndafilohet!
Dhe afrohet, te xhami më del:
«Hap dritaren të futem, — më thotë, —
Sepse unë jam fjala që çel!»

Hap kanatet! Plot dritë e plot lule,
Ajo sulet e n'ajër nis shkruan...
Prapa saj sulet era. Pas erës,
Befas vargjet! Ç'e humba toruan!

Se tek rrija lulzoja i qetë,
Vetmitar, me të blertat mendime,
Këtë gaz, këtë all kaq të ndezur,
As e prisja në dhomëzën time.

Murmurimi pa fund ngjyrë alli,
Kundërmimi i ëmbël, freskia,
Befas erdhën, ndër gishta m'u derdhën,
Nëpër penë e në ritmet e mia.

Dhe më bën kjo e bukura degëz,
Me lulzimin plot dritë nga jeta,
Të hedh allin e ndezur ndër vargje,
Mbi të gjitha mendimet e blerta.

NGA POEZIA GREKE

DH. SOLLAMOS

KATASTROFA E PSARASË

Në Psara, ku sundon qetësia,
Nëpër shkumb endet vetëm Lavdia,
Me vështrimin mbi trimat e ndritur,
Dhe kurorën mbi flokët e vet
E ka thurur nga bar' i përzhitur,
Që ka mbetur në tokën e shkretë.

BOÇARI

Zinxhirin, që në zgjedhë e mban,
Kur e këput papritur,
Luani krifën tund me tmerr,
Dhe duke ulëritur,
Vështrime t'egra, flak' e zjarr,
Rreth vetes shigjeton,

Dhe shqyen, me të tmerrshmit thënj,
Ata që roje i rrinë,
Duke ua flakur me tërbim,
Kujt zorrët, kujt mëlçinë,
Dhe njolla gjaku lë gjithkund
Në rrugën ku vrapon..

Elladö! Si luan, dhe ti
U ngrite e mbi dhë
Lëshove befaz me tërbim

Vështrimin tënd rrufe,
Prej syve, ku të zgjedhës lot
Endë s'të qenë tharë,

Dhe shpata e rreptë e mllefrit tënd,
Çelik e plumb e rëndë,
U ngrit e korri mizëri
Armiqsh të tokës tënde,
Ashtu sikundër drapëri
Kallinj të nëpër arë!

Kur midis gjeneralëve,
Kish marrë grindja zjarr,
U shfaq Bocari dhe, në çast,
Vështrimi shkrepimtar
Dhe vetë namja e tij, ndër ta
Vendosi qetësinë.

Pa foli: «Sonte, more miq,
Sapo të fshihet hëna,
Unë do futem fshehtazi
Në kamp të turqve brenda
Dhe me të paktit djemtë e mi,
Mbi ta do bëj kërdinë,

E djathtas, varr për osmanllij
Do kthehen shkrepë e shpatë!
Ju majtas befaz turruni,
O luftëtarë nate,
Të tunden pyjet anakënd
Dhe toka tym të nxjerrë!

Këto tha gojëflakti trim,
Pastaj u ul e heshti.
Dhe midis gjeneralëve,
Papritur grindja rreshti,
Se fjalë e Markos, ç'qenë aty
I bindi menjëherë.

A. PARASKU

JETIMI I KRETËS

Një vogëlush, si lule e fishkur, te një rrugë e
thellë.

I lodhur, sa s'çapitej dot,
Me sytë e mbushur plot me lot,
Vështronte lart nga qielli.

Me rrëbe të përzishme e pashë të gjorin atë
mbrëmje;

Dhe mua, që s'duroj dot zi,
Aq më tronditi pamja e tij,
Sa thellë ndieva dhembje!

Që ishte rritur me kujdesje, menjëherë njihej;
Te gjiri i mëmës, deri dje,
Atje në t'ëmbëlën fole,
Si zog i lumtur ndihej.

Po krisi pushka e Kreta u ndez nga flakët
anembanë.

Ai folezën më s'e pa,
Pa mëmën plumbi turk e la,
Beteja, pa babanë.

I ngrysur e të nxehtin lot me zor duke gëlltitur,
E zgjaste dorën heshtazi
Gjithë turp, e s'thoshte kurrsesi
Që ishte i uritur.

.

Bujare nëna, që të lumtur djem keni rreth
vetes,

Uria rrugësh po i grin,
Thëllimi i natës po i ngrin
Të shkretët djem të Kretës!

KËNGË KOMITËSH

Kur do të vijë një pranverë, apo një verë e
bukur,
Të shkrijë borën e ngado të lulëzojnë pemët,
Të ngjeshim armët e gjerdanët larë n'ar, për
brezi,
Edhe të dalim maleve komitë, more djema!
Te zemr' e majës më të lartë, atje ta ngrejme
çerdhen.
Me yjtë e qiellit në kuvend të shtrohem i ndër
netë,
Së pari neve të na i japë agimi përshëndetjen,
Së pari ne të na vështrojë dielli më të lindur!
Shqiponjat të na kenë zili, bilbilat të na zgjojnë
Edhe ndër ujrat si kristal, burimeve të ftohta,
Të vijnë zanat të na lajnë e puthje të na falin!
Papo ndër pisha armët ne t'i varim radhë-radhë,

Pastaj të hedhim valle tok! Papo çdo këngë
Të jetë si gjëmim prej nesh, si zjarr prej
Të kenë bishat tmerr nga ne e të na dridhen
Ah, kur do vijë një pranverë, apo një verë e
Që ne të dalim maleve komitë, more djema!

K. PALLAMAS

SHTËPIA KU KAM LINDUR

Shtëpia ku kam lindur, le të shkelesh nga të
Stihj ti je për ta, po mua rri më pret ngaherë,
Me kopshtin, me kalldrëmin tënd, ku mall më
Shtëpizë e dashur, ti ndër sy më shfaqesh si
dukur.

Paçka së sot gjithçka ndryshon nga pamja jote
Ti, strehë e bëlbëzimit tim, më pret e pacënuar!
Ja porta, nën të vjetrin hark, me po ato
Veç telat, i mungojnë asaj të kthehet në kitarë,

T'i shoqërojë këngözën shtëpisë e prap në lule
Ta kthejë djalin që u rrit këtu me aq pekule,

Në zog te çerdhja e prindëve, te lodrat, te
Te prehr' i mëmës, kur fillojnë e zbardhëlojnë
gëzimet,
agimet.

Kaluan vitet, pleqëria rri diku përgjon,
Por e patundur mbabesh ti, kapitjen e dëbon,

Sikur prej ligjeve të fatit as që do t'ia dish.
Nga kopshti yt kurora sot për mua thur sërish!

Për sy të tjerë, mbase drejt rrënimit vete ti,
Po ndryshe të shikojnë ata e ndryshe sytë e mi.

Kaloj sallonin e në dhomë hapin hedh ngadalë:
Sahati i artë vezullon nën veshjen prej kristali:

Vendosur plot me harmoni, gjithçka përreth
shkëlqen;
Çdo orendi sikur më thotë: «Mirë se po na
vjen!»

Ja gjyshja, pranë shërbëtores, mbahet si
princeshë,
Dhe mëma, e shtrenjta e shpirtit tim, e ëmbla
pëllumbeshë,

Që, si shenjtores, një fëmi të vogël mban në
duar!
Më tej, vegimi i tim et, mbi shkresa
përqendruar.

Dhe tej dritares, larg në kopësht, shoh vëllain
tim,

Mes mendrash edhe trëndafilash plot me
kundërimim.

Kurse më thellë, befas, krejt si prej një tjetër
bote,

Si nëpër ëndërr më fanitet vasha hirëplote,

I pari mall i shpirtit tim, profetësia ime,
Që shkrepëtin, kur buzëqesh, agime e
perëndime...

Shtëpia ku kam lindur, le të shkelesh nga të
tjerë, —

Stihi t'i je për ta, po mua më thërret ngahërë...

NGA POEZIA ITALIANE

XH. KARDUÇI

KËNGË MAJI

Hare sjell ndër çerdhe maji,
Ëndrra në zemra zgjon;
Dhe hithra, edhe trëndafili,
Dhe gjarpri, dhe zogu këndon.

Zhurmojnë ndër pellgje fëmijët
Dhe këngë këndojnë bilbilat;
Vasha, që digjet prej mallit,
Mpleks në gërshet trëndafila.

Lulkuqet si zjarr flakërojnë,
Ngadoqë vështrimin të hedhësh.
Gjithçka dashuron e rinohet:
Dhe toka, dhe uji, dhe qielli.

Po thellë në zemrën time
Driza dhe ferra harbon;
Në tru më këndon kukuvajka,
Nëpërka në gji më pickon.

KUR BIE BORË

Lehtazi flokët e borës bien prej qiellit të
mvrejtur,
Rrugët sikur kanë vdekur, gjindja ka
heshtur mbi dhe:

S'ndihen më thirrje te bregu, as kërkëllima
pajtonesh,
Këngë gazmore dashnorësh as që dëgjohe
gjekund.

Derdhen prej kullës së lartë tingujt e fortë
të orës,
Botë e panjohur për njerzit heshtaz së
thelli rënkon.

Zogjtë te xhamat trokasin. Shpirtrat e mirë ata
janë,
Mua kërkojnë mbi tokë, mua në qiell më
thërrasin;

Prisni, të dashur, ja, erdha (hesht, moj e
çmendura zemër!),
Në terrin e qetë të varrit do vij, e do prehem
ngamot.

NGA POEZIA GJERMANE

H. HAJNE

SA HERË...

Sa herë n'udhën tënde
Mëngjeseve ndodh që kaloj,
Gëzohem, o zoçkëz e dashur;
Kur ty në dritare shikoj.

I dhembshur e krejt i pafajshëm
Vështrimi i syve të tu
«Ç'je ti, o i huaj, — më pyet, —
Dhe pse heq e vuan kështu?»

Poet jam, o foshnjëz, i njohur
Në kombin tim gjerman;
Kush njeh midis nesh më të mirët,
Patjetër prej tyre s'më ndan.

Si unë, dhe shumë të tjerë
Atje heqin keq dhe zi;
Kush brengën e madhe ka njohur,
Patjetër që dhembjen ma di!

LORELAI

Nuk di pse jam kaq i hutuar,
Kaq brengë pse kam në gji;
Një prallëz e kohës së shkuar
S'më hiqet nga mëndt kurrsesi.

Fillon errësohet. Rini
Në heshtje të thellë dremit
Dhe shkëmbin në breg perëndimi,
Me rrezet e fundit shkëndrit.

Atje, majë shkëmbit të lartë,
Këndon ëmbëlsisht Lorelai;
Dhe petku i shtatit, i artë,
Dhe krëhri në dorën e saj.

Papo nëpër t'artën gërshetëz,
Plot hir ajo krëhrin kalon.
Dhe kënga magjike, fshehtas
Gjithë vendin përreth e pushton.

Shastisur prej saj, lundrari
Çan rrjedhën me vrull, po ç'e do:
Nuk sheh që shkëmbinj ka përpara,
Se syt' i mban lart, tek ajo!

Tani, unë e di, lum' i gjerë
Mbi të rrjedh me shkullm e vaj.
Dhe gjith' këtë gjëmë e bëri,
Me këngën e saj, Lorelai.

V J O L L C A

Në një luginë më blerim
Kish çelur plot freski n'agim
Një vjollcë e urtë, e drojtur;
Papratur na kalon atje,
Si flutur, një bareshë e re,
Gjith' shënd e gaz
E këngë plot harë.

«Ah, sikur t'isha, — vjollca tha, —
Mes luleve m'e bukura,
Një çast, një çast të vetëm,
Do më këpuste domosdo,
Në gji do më shtrëngonte ajo
Një çast. një çast,
Të paktën, për një çast!»

Por shkon aty baresha e re,
Dhe nëpër bar as e vë re,
E shkel të shkretën vjollcë.
«S'ka gjë, — tha lulez' e pafaj, —
Të bukurës mëri s'i mbaj,
Se në po vdes,
Po vdes nga këmba e saj!»

PERËNDIA DHE BAJADERA

Perëndi' e rruzullimit,
Mahadeva, zbret mbi dhë,
Hallet, dertet e gëzimet,
Për t'i ndarë tok me ne.
Deshte vetë ta jetonte
Këtë botë si njeri,
Mëkatarët t'i gjykonte
Paskëtaj me drejtësi.

U vesh si shtegtar dhe qytetit kaloi,
Të fortët përgjoi, të vegjlit dëgjoi
Dhe bëri të nisëj më tej përsëri.

Afër portave. një vashë
Të përdalë ai na pa,
Veshur me fustan mëndafshi,
Me të hua e me këna.

«Tungjatjeta!» «S'jam për nderë,
Kot, or mik, më përshëndet!»
«Pse, ç'je ti?». «Një bajaderë,
Pragu im dashnorë pret...»
Dhe nis e kërcen duke çukur çaparet,
Përdridhet rreth tij e me gjeste bujare,
Me lule, në strehën e vet e thërret.

«Eja, shtegëtar i bukur,
Që të sjell i lumi fat!
Sa të hysh, do të të duket
Cerdhja ime si pallat!
Të lan këmbët mikia joftë.
Të flladit e fë freskon,
Cdo dëfrim të kësaj bote
Me gjith' zemër ta dhuron!»

Dhe mikun e pret me të gjitha kujdesjet;
Ai e gjurmon e s'ia ndan buzëqeshjet:
Një shpirt qelibar mes mjerimit shikon.

Befas nis t'i sillet egër,
Sikur skllave t'ish për të;
Vajza kryet ul më tepër,
Kryet ul e nuk bën zë.
Kështu lulja shkund petalet,
Frutin kur fillon e ngjiz,
Porsi zemra, ku ngadalë
Dashuri' e pastër nis.

Ai, që zbulon të kushdo çdo të fshëhtë,
S'lë prova pa bërë me vajzën e shkretë:
E tremb, e gëzon, e trishton, e sëndis.

Dhe siç është' ashtu gjith' bojë,
E pushton dhe fort e puth!
Vajza nis të fërgëlojë,
Për së pari qan me duf
Dhe më gjunjë atij i bie,
Jo për epsh, as për shpërblim;
E këputur fare ndihet,
S'ka më forcë për shërbim.
Dhe velin e ëndrrave hijet e natës
Filluan të endin ngadalë mbi shtratin
E çiftit të lumtur, në t'ëmbilin harrim.

Por n'agim, pa zbardhur mirë,
Zgjohet vajza plot me tmerr:
Djali i dashur krejt ka ngrirë,

As e ndien, as frymë merr!
Kot rënkimet, kot të qarat,
Kot e puth e kot e lut!
Trupn' e tij te gropë e zjarrit
Venë e shpien me tabut.

Dhe teksa rreth gropës nis këng' e varrimit;
Ajo çan mes turmës me britma, gulçime...
«Ç'je ti? Ç'do këtu? Ç'po kërkon me kaq
ngut?»

Ajo, gjithë klithma e lot,
Turret drejt të shenjtit zjarr.
«Burrin tim kërkoj, — u thotë, —
Do të hyj me të në varr!
Ah, ky nur, që zjarri i shkretë
Do ma bëka shkumb e hi,

Imi ishte dhe do mbetet,
Imi në përjetësi!

«Ky zjarr, — mërmërijnë brahmanët rreth
flakës, —

Ky zjarr i përmotshëm nuk djeg vetëm

plakun,

Por edhe të riun plot hir e freski!

Dëgjo Brahmën që të bindesh:

Burri yt ai nuk qe,

Ndaj te zjarri kot avitesh,

Ti një bajaderë je.

Veç të vejave u njihet

Prej të shenjtëve ky nder:

Trupi merr nga prapa hijen,

Kurse burri gruan merr.

Buçisni borije, daulle gjëmoni,
O zotër, së toku me flakën, pranoni
Një shpirt, që drejt jush fluturimin po
merr!»

Kori helm ia bëri gjakun
Bajaderës së pafat;
Dhe u hodh ajo në flakë,
Drejt e në të vdekjes shtrat.
Po prej gjuhëve të zjarra,
Perëndia shpejt u ngrit,
Rroku miken, rrahu flatrat
Edhe lart në qiell u ngjit.
Me krahët e flaktë kështu perënditë
I marrin ata që pendohen një ditë,
Atje ku gjithçka vetëtin e shkëndrit.

BURRI I MIRË DHE GRUAJA E MIRË

Baladë skoceze

Qe natë e t'urtit shën Martin;
Ç'u lodh e ç'u mundua
T'i bënte burrit plum-buding
Për festë, e mira grua.

Dhe bien flenë, por ia nis
Një erë gjith' poterë.
«O grua, çohu, — burri flet, —
Dhe hidhi kanxhën derës!»

«Ohu, nuk loz, — ia kthen ajo, —
Jo erë, po ç'të jetë!
Jam lodhur aq sa unë e di,
Po deshe, çohu vetë!»

U grindën mjaft e më në fund
«Ta mbyllim, — thanë, — sherrin:
Kush do të flasë i pari prap,
Ai do mbyllë derën.»

Nga mezi i natës vijnë aty
Në terr, dy udhëtarë;
«Ç'të jetë, — thonë, — kjo shtëpi,
Ku s'ndihen zëra fare?»

Shikojnë vatrën, për çudi,
Endë thëngjij që digjen!
Thërrasin, po përreth në terr
Askush s'ua kthen përgjigjen.

«Pa shih, pa shih, ky plum-buding!
Nga furra paska dalë!»
Përbrenda nikoqirja zjen.
Por hesht e s'flet një fjalë.

«Sikur ta njomnim grykën ca,
Do t'ishte feja vetë!»
«Pa dal ta hap këtë dollap,
Se, them, diçka do ketë...»

«Shiko, plot shishja me raki!»
«Po hë, vëllaçko, ç'presim?
Ti hidhmë mua, unë ty, —
Ta zbrazim, se po vdesim!»

SHKËMBITË E SHKËMBITË

SHKËMBITË

Po burri i mirë n'atë çast

E humbi krejt toruan.

«Kush më prek shishen, — thirritfort, —

Me kokë ma paguan!»

Dhe gruaja e mirë aty

Kërceu menjëherë:

«E humbe, burrë i dashur, — tha, —

Pra çohu, shko mbyll derën!»

NGA POEZIA BRITANIKE

R. BÉRNS

PËRKTHYESIT TË MARCIALIT

Epigram

O ti, që poezia të dha duart,
Që as me prozën nuk re dot n'ujdi,
Dëgjon si po bërtet poet Marciali? —
«O ndihmë! Ndhmë! Më përktheu ai!»

LAVDIA

Lavdia, kur ndokush nga pas e ndjek,
Merr vrapin, porsi egërsira e pyllit
Dhe krejt papritur vjen u del në shtëg
Çapkëneve, që fare s'e përfillin.

Dhe është' aq kryeneçe, sa përçmon
Këdo që rri e pret i përvëluar;
As emrin t'ia përmendësh nuk duron,
Se dhe ashtu në nder e ke cënuar.

Kurbatkë e shkretëtirës është ajo,
Që valën blu të Nilit ka pasqyrë.
Prandaj, poet, pas gjurmësh mos i shko,
Përplasja mospërfilljen në fytyrë,

Se me përçmim atë po ta shpërblesh,
Si skllaven tënde nesër mund ta kesh.

LLOHIN — GARI

Ç'më duhen peizazhet mes parqesh gazmorë,
Ku lypin idhtarët e modës qetsinë!
Më jepni shkëmbinjtë mbuluar me borë,
Në ta un' e gjej dashurin' e lirinë!
I dua të ngrysurat kreshta, ku ndizen
Në shqot' e shtrëngatë rrufetë plot zjarr,
Ujvarat plot shkullm e buçim të Skocisë, —
Gjithnjë të kam dashur me shpirt,
Llohin-Gar!

Tek ti, si malsor, me mantel e beretë,
Sa herë jam endur, i vogël kur isha;
Heronjt' e dikurshëm, fatosët me fletë
Kujtoja në muzg, nën të thinjurit pisha.
Dhe derisa mjegullat shkrepat mbulonin

E qielli mbushej me yj rreze-ar,
Legjendat e moçme në shpirt më kumbonin,
Rrëfimet për trimat e tu, Llohin-Gar!

O hije të rënësh! Ahere ju vallë
Në kor më buçisnit, kur niste stuhia?

Oh, shpirt' i heronjve gjithmon' është' i gjallë
Dhe endet me erën mbi viset e mia!

Atje, midis reve, mbi t'akulltën qerre,

Kalon dimr' i egër, si mbret sundimtar,
Drejt tij avuj mjegullash ngrihen ngaherë,
Me shpirtrat e gjyshërve tok, Llohin-Gar!

Fatzes luftëtarë! S'e dinit që fati

Për ju kishte ngrehur një pritë aq mizore?

Me gjakun e kuq Kullodenën e latë

Dhe s'morët mbi varre dafina fitoresh.

Por jeni të lumtur, se ratë si burrat
Dhe gjumin jua ruan i shënjtë Bremar,
Legjendat dhe këngët lavdinë ju thurin,
Dhe ti, me jehonat pa fund, Llohin-Gar!

Prej teje kam ikur dikur, po gjithmonë
Zhuritem nga malli për grykat e tua,
Ti s'je plot me lule. si fush' e Albionit,⁽¹⁾
Po prap je në botë m'i shtrenjti për mua!
Ç'e dua shkëlqimn' e blerimit të qetë!
Mes shkrepave zemra më mbushet plot
zjarr!

T'i dua shkëmbinjtë, përrenjt' e rrëketë,
Gjithnjë të kam dashur me shpirt,
Llohin-Gar!

1) Albion quhet ndryshe Anglia. Emrat e tjerë janë vende në Skoci.

TI QAN...

Ti qan e loti vetëtin
Qerpikëve të tu;
Elmazi i vesës në agim
Prej vjollcës shket ashtu.
Ti buzëqesh, ç'i ëmbël gaz
Shkëndrit në sytë e tu;
Safiri zbehet n'atë çast
Nga flakë e tyre blu.

Purpurn' e reve ruan ti,
Kur dielli perëndon,
Dhe errësira pa kufi
Nis botën e mbulon.
Kështu edhe vështrimi yt
Djeg retë e shpirtit tim;
Le t'errët! Brenda meje ndrit
I zjarri perëndim!

KËNGA E MEDORËS

(Nga poema «Korsari»)

Në zemrën time kam diçka të fshehtë,
Atë në botë nuk ma di njeri;
Kur jemi tok, lulzon si lulja vetë,
Por hesht sërish në terr, kur ikën ti.

Një fill i artë shpirtit m'i jep dritë,
Po rrezet nuk i shihen dot me sy;
Atë mbi dhé s'ka forcë ta venitë,
Se errësira nuk arrin aty.

Oh, dhe në vdeksha, sillmë nëpër mendje,
Kujtoje miken që të desh me zjarr;
Se ta duroj, e mjera, s'jam në gjendje,
Harrimin tënd, i dashur, as në varr!

Një amanet plotsoma, po të mundësh,
Se nuk do të të lutem përsëri:
«Një pikëz lot, të parin e të fundit,
Për dashurinë time derdhi ti!

NGA POEZIA AMERIKANE

H. LONGFELLOU

SHIGJETA DHE FJALA

Prej harkut u këput shigjeta,
Po ku arriti nuk e di,
Se mori aq me vrull përpyetë,
Sa humbi nëpër kaltërsi.

U nis në botë kënga ime,
Po ku arriti nuk e di;
Në male e fusha me blerime,
Nuk mund ta ndiqnin sytë e mi.

Kaluan vite dhe shigjeta
Në trungun e një lisi u gjend,
Kurse të shtrenjtën këngë e gjeta
Te zemra e miqve, në çdo vend.

EXCELSIOR (1)

Përmes një fshati alpin dikur,
Dëborën çante nëpër terr
Një trim i ri, me një flamur
Që kish simbolin plot mister:
Excelsior!

Vështrimn' e rreptë dhe krenar,
Si thikë e kish, që shponte larg.
Dhe zgjonte thirrja e tij plot zjarr,
Si bri argjendi, malet varg:
Excelsior!

Kallkan e ciknë përkundrejt,
Shtëpi plot ngrohtësi përbri;
Porse nga buzët, akull krejt,
Një klithmë ushtonte me furi:
Excelsior!

I tha një plak: «Qëndro, djalosh,
Se vjen tufani e mbyll çdo shteg
Dhe ti nuk di se nga të shkosh!»
Po prap gjëmimi si ortek:
Excelsior!

Iu lut një vashëz: «Eja, o trim,
Rri çlodhu pak në gjoksin tim!»
Një pikëz lot në faqe i ra,
Po zemrën mblodhi fort e tha:
Excelsior!

Ia dha tufani! Gjer përdhe
Përkuli pishat rreth e qark!
Po prap ushtima e rreptë u ndje,
Përmes rrungajash, diku larg:
Excelsior!

Agimi ndezi majat zjarr,
Kur mbi të psallmës mërmërim,
Në manastirin San Bernar,
Buçiti thirrja plot guxim:
Excelsior!

Po ku mbet trimi? Borën shpejt
Rrëmihu qeni i tij, veç kot:
Ai kallkan qe kthyer krejt,
Flamur e trup shtrënguar fort!
Excelsior!

Kështu. gjith' nur edhe në mort,
Mbet trimi mbi një shkëmb alpin.
Por amaneti i tij ngamot
Si ylli udhërrëfyes ndrin:
Excelsior!

1) Excelsior (latinisht) — Përpara dhe më lart.

DY SHIKOJNË DY

Harrimi i dashurisë ata i shpuri
Jo shumë larg, por lart, nëpër një pyll.
Në shpatin e një kodre. Zu të errej.
E pra kish ardhur koha të qëndronin
E të kërkonin udhën për t'u kthyer,
Sidoqë t'ish ajo, me gurë e gropa,
Apo me pellgje kredhur n'errësirë.
Në këtë çast, një gardh me tel me gjëmbe
I bëri që të ndaleshin papritur.
Në sytë e tyre ndrinte ende dëshira
Për t'ecur prap përpara e përpara,
Po befas, ja pengesa. Nata shtrihej
Përpara tyre e shpati ish i pjerrët,
Aqsa po të lëvizje ndonjë gur,
Do rrokullisej vetë tatëpjetë.
«Kjo që e gjitha. Natn' e mirë, o pyll!»

Po ja, s'qe kjo e gjitha: Para tyre
Një dre qe ndalur e po i vështronte
Pa pikë frike; duket, nëpër natë,
Ashtu të palëvizur, i kish marrë
Për ndonjë shkëmb me një si çarje t'errët.
Po shkëmbi, shkëmb, — sido, sido të jetë,
Kureshtje nuk të zgjon, kështuqë dreri
U mbush me frymë e iku mengadalë.
«Epo kjo qe e gjitha!» Ja që s'qe,
Sepse një zë i bëri prap të shtangnin.
Përpara, afër gardhit, nën një bredh
Ish ndalur një kaproll e i vështronte.
E pra s'qe kthyer dreri përsëri!
I brishtë, i shqetësuar, ai shihte
Edhe gërhinte me të gjerat flegra,
A thua po i pyeste: «Po ç'keni?»

Pse s'luani nga vendi? Nuk po mundni?
Ju gati-gati s'ndiheni të gjallë».
Dhe aq i dhëmbshur qe vështrimi i tij.
Saqë ata, për pak, i zgjatën duart.
Por çasti i bukur iku, se kaprolli
Kërceu gardhin edhe mori pyllin.
Dy panë ata edhe nga dy u panë:
«Kjo qe e gjitha». Po, kjo qe e gjitha.
Mirëpo tani diçka ata seç prisnin,
Pështjellë befaz nga një valë e ngrohtë.
Qe vetë toka, që me shpirt u foli
Të dashuruarve për dashurinë.

PËRMBAJTJA

«Në një rreth miqsh më pyetën një ditë» ...	3
«Shtegëtar, që kalon monopatin»	5
«Kaq dëshira ne po mbajmë fshehur»	6
Bulkthi	7
«Bregën e madhe mbyta në një gotë»	9
Baladë	11
Në tës	13
«Këngë, jetë, dritë, hapësirë»	15
Harabelat	17
«Pemët anës rrugës dridhen në vallzim» ...	19
«Unë e di që ti tani, për mua»	21
Mbrëmje ushtarësh	23
«Dëgjo ç'thonë gjethet më të rënë»	25
«S'c marr vesh, o Jorgo, punën tënde»	27
«Ra nata mbi fushën pa anë»	29
Frosina	30
«Kur padashur humbas ndër kujtime»	32
«Kojrillë, kojrillë»	33
«Sy femënorë dhe plot me shkëlqim nga mendimi»	35

«Më vjen turp të qaj i heshtur»	36
Tufani	38
«Gjithë fusha humbi nëpër mjegull»	45
«Ti këdo mbi dhe do ta çuditje»	46
«Kur buzëqesh plot gaz e shend»	48
«Ne fshehtazi shkëmbejmë shpesh vështrime»	49
Sonet i përmbysur	50
«Natyre e përtëritur në pranverë»	51
«Petalet bien; era mengadalë»	52
Kukëza	53
«O mik i shtrenjtë! Shkuan kaçë vjetë»	55
Jeta	56
«Sa pisk e kam, sa dhëmbje ndjej, sa dua»	58
«Dy hapa larg e vite për t'arritur»	59
Natë pa këngë	60
«Të lë shëndenë, o shok, o mik, që thellë»	63
«Në tetor, kur prarohen korijet»	65
«Pse ke zgjedhur natën, more i ngrati gjon»	67
«Ne duheshim si pjergulla me plepin»	68
«Përpara se me britmën e çjerrë dhe të ashpër»	70
«Unë ngjaj me bredhat nëpër male»	72
«Oh, ç'natë! Prej tokës së thelli»	73
«Mban mend? Kësaj rruge dolëm»	76
«Një mbrëmje si kjo tek shëtisnim»	77
«Kur m'erdhi ajo në dhomëzën e thjeshtë»	78
«Tokë e ëmbël»	79
«Mbi trëndafilin flutura qëndroi»	81
Kënga e Shemo Kasos	82
«Ah, nën këto akasje të thara krejt pothua»	85
«Gëzimm' e dashurisë syzezës a sykaltrës»	86
«Medet se ç'hall i madh më gjeti»	87
Dielli dhe vllaga	89
«Krahët e xhamtë ka shtrirë»	92

Vreshti i poezisë	93
Plaku i urës	95
Vallja e Osman Takës	97
«Një mbrëmje, për t'u shlodhur kisha dalë»	100
«Eja, kënga ime, s'kemi ç'rrimë»	102
«Këndeje armik, andej edhe më zi»	104
«Ç'po më trishtoka ky kavak i zhveshur» ...	105
«S'i mbaj mëri për vitet e rinisë»	107

SHQIPËRIME

NGA POEZIA KINEZE

DU FU — Papagalli	111
Skifteri	113
Pata e egër	114
Margaritarët	116

NGA POEZIA PERSIANE

KIL RUMI — Hardhia e egër	118
M. SAADI — Pikëza e shiut	120

NGA POEZIA RUSE

A. S. PUSHKIN — I burgosuri	121
Karroca e ietës	122
A. P. Kernës	124
Mbrëmje dimëri	126
«Sa ju kam dashur...»	128

	Kënga e Zemfirës	129
A. BLOK	— Zogu i rrallë	131
S. ESENIN	— Era e dëborës	132
	Puthmë, moj e dashur	134
	Mështekna	137
	Prag muzgu	130
	Njeriu i zi	141

NGA POEZIA UKRAINASE

T. SHEVÇENKO	— Amanet	151
--------------	----------------	-----

NGA POEZIA POLAKE

J. TUVIM	— Degëza	153
----------	----------------	-----

NGA POEZIA GREKE

DH. SOLLOMOS	— Katastrofa e Psarasë ...	155
J. ZALLOKOSTAS	— Boçari	156
A. PARASKU	— Jetimi i Kretës	159
K. KRISTALIS	— Këngë komitësh	161
K. PALLAMAS	— Shtëpia ku kam lindur ...	163

NGA POEZIA ITALIANE

XH. KARDUÇI	— Këngë maji	167
	Kur bie borë	169

NGA POEZIA GJERMANE

H. HAJNE	— <u>Sa herë</u>	171
	Lorelai	173
J. V. GËTE	— Vjollca	175
	Perëndia dhe bajadera	177
	Burri i mirë dhe gruaja e mirë	184

NGA POEZIA BRITANIKE

R. BÉRNS — Përkthyesit të Marcialit	188
XH. KITS — Lavdia	189
XH. BAJRON — Llohin — Gari	190
Ti qan	193
Kënga e Medorës	194

NGA POEZIA AMERIKANE

H. LONGFELLOU — Shigjeta dhe fjala ...	196
Excelsior	197
R. FROST — Dy shikojnë dy	200